




**ASCAP**

**2022**



# MËSIMI I KOMBINUAR

NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ

**ASCAP**  
Material ndihmës

**SHTATOR 2022**  
[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)

Materiali “Mësimi i kombinuar në lëndën e gjuhës së huaj” u hartuan nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).

Ky material ju vjen në ndihmë mësuesve të gjuhës së huaj të arsimit para universitar për të planifikuar dhe organizuar orë mësimi gjithëpërfshirëse duke u bazuar në parimet e mësimi të kombinuar.

Mësuesit do të gjejnë në këtë material jo vetëm shpjegime teorike mbi parimet dhe avantazhet e mësimi të kombinuar por edhe shembuj praktikë për aplikimin e burimeve të ndryshme digjitale.

*Hartimi i dokumentit u koordinua nga:*

Ludmilla Stefani

*Grupi i punës:*

Elida Reçi


Ermelinda Laca

Luljeta Malaj

Julinda Sinani

Odeta Islamaj

# Përmbajtja

- 01** Hyrje
  - 03** Mësimi i kombinuar
  - 05** Avantazhet e mësimit të kombinuar
  - 07** Nga të fillojmë
  - 11** Mjete teknologjike për përdorim në lëndën e gjuhës së huaj
  - 66** Shembuj praktikë për përdorimin e mjeteve të teknologjisë në lëndën e gjuhës së huaj
  - 86** Bibliografia
- 

# Hyrje

Studimet e kryera tregojnë se shumica e nxënësve përdorin celularët më shumë sesa kompjuterat ose laptopët. Në ditët e sotme, mësuesit e njohin rëndësinë e përdorimit të burimeve digjitale për të zhvilluar mësimin në mënyra të ndryshme, interesante dhe gjithëpërfshirëse. Rrethanat aktuale kanë bërë që shkollat, universitetet dhe kolegjet në mbarë botën të rimendojnë mënyrën se si ta organizojnë mësimin në një botë ku teknologjia luan një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe atë akademike. Teknologjitë edukative të mësimdhënies kanë evoluar me një shpejtësi marramendëse drejt përfshirjes së mjeteve digjitale në procesin mësimor, një fakt ky që mund të shqetësojë mësuesit të cilët kanë vetëm përvojën e mësimin të drejtpërdrejtë në klasa.

Për vite me radhë celularët dhe aplikacionet e tyre kanë qenë njohur si teknologji mësimore. Mësuesit mund të lidhen me nxënësit dhe t'i udhëzojnë ata përmes Whatsapp-it, apo platformave si: moodle, software dhe aplikacione digjitale, të cilat janë të disponueshme në të gjithë botën. Përfitimet kryesore të këtij procesi janë: rritja e interesit, përfshirja e nxënësve në orën e mësimin dhe rënia e ndjeshme e konsumit të letrës.

Nevoja për të zotëruar mësimdhënien online është bërë thelbësore. Është shumë e rëndësishme që mësuesit të cilët nuk janë ende në gjendje të përdorin teknologjinë të motivohen në kërkimin dhe përdorimin e burimeve online në celularë (laptop apo tableta) në mënyrë që mësimdhënia e gjuhëve të jetë efektive për nxënësit. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të përdorin burime si: faqe të internetit, blogje dhe mjete digjitale të cilat i ndihmojnë ata të kalojnë me sukses nga mësimi i drejtpërdrejtë në klasë në mësimin online (ose të kombinuar), si dhe të përshtasin ekspertizën e tyre me situatën aktuale.

Teknologjitë e mësimdhënies dhe të nxënësive janë fleksibël (mësuesit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë internetin) të cilin mund ta përdorin për mësimin:

- e drejtpërdrejtë në klasë
- hybrid ose të kombinuar (i drejtpërdrejtë në klasë dhe online)
- 100% online.

Nxënësit, tashmë të njohur si “Gjenerata Z”, janë duke përdorur teknologjinë në mënyrë të vazhdueshme dhe shpesh presin që mësuesit e tyre të ofrojnë përvoja mësimore duke përdorur rrjetet sociale dhe aplikacionet që mund të kenë në celularët e tyre. Shtrohet pyetja: “Si mundemi ne, si mësues të gjuhës së huaj, të përmirësojmë përdorimin e teknologjisë në celularët tanë?” Nëse në shkollë ka internet, mësuesit mund të përdorin mjete digjitale dhe faqe online për të përmirësuar praktikën e tyre të mësimdhënies.

---

# Mësimi i kombinuar

Në fjalorin e Oxfordit, mësimi i kombinuar përkufizohet si një mënyrë e të studiuarit të një lënde, e cila kombinon të mësuarin në klasë me përdorimin e teknologjive të ndryshme duke përfshirë edhe përdorimin e internetit.

Si pasojë e pandemisë së Covid-19, mësimi online u bë një situatë normale dhe ky normalitet i ri në arsim kërkon nga gjithësecili ndryshimin e rutinës së jetës. Si rezultat, mësimi i kombinuar tashmë në të gjithë botën është një qasje e zakonshme ku nxënësit mund të mësojnë në klasë dhe ta kombinojnë këtë me të nxënin online.

Pavarësisht të qenit në epokën digjitale, procesi i të mësuarit në klasë mbetet shumë i rëndësishëm dhe është detyrë e mësuesve të udhëheqin nxënësit dhe t'i ndihmojnë ata të përmirësojnë katër aftësitë kryesore të shekullit 21 (*Mendimi kritik, Komunikimi, Krijimtaria dhe Bashkëpunimi*). Për të përgatitur një brez të ri, të aftë të konkurojë dhe të zhvillohet në tregun botëror të punës, si dhe të jetë gati të përballet me sfidat e dekadës së ardhshme, mësuesit duhet të aplikojnë mësimin e kombinuar dhe katër aftësitë e shekullit 21 në normalitetin e ri të arsimit.

Mësuesit gjithmonë e kanë të vështirë të përshtatin mësimin sipas nevojave të secilit nxënës. Modelet e mësimit të kombinuar mund t'i ndihmojnë mësuesit dhe nxënësit të personalizojnë përvojat e tyre të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mësimi i kombinuar realizohet në forma të ndryshme dhe mësuesit mund të përshtasin qasje të ndryshme duke u bazuar në nevojat dhe nivelin gjuhësor të nxënësve të tyre.

## Modelet e mësimit të kombinuar:



### Mësimi i drejtpërdrejtë në klasë

Mësimi tradicional i cili pasurohet me teknologji për të ndihmuar nxënësit të kenë kontroll mbi të nxënin e tyre.



### Modeli i rrotullimit

Nxënësit rrotullohen në stacione të ndryshme pune e në secilin stacion ka një detyrë të caktuar për të kryer. Kjo lëvizje mund të bëhet me një orar fiks ose edhe individualisht. Nxënësit realizojnë detyra online, në klasë, në grupe të vogla, individualisht etj. Formë e modelit të rrotullimit është edhe klasa e këmbyer (Flipped Classroom). Në këtë model nxënësit mësojnë online në shtëpi dhe shkojnë në klasë për t'u ushtruar me veprimtari të ndryshme, projekte etj.



### Modeli fleksibël

Mësimdhënia dhe të nxënit realizohen online dhe mund të plotësohen me orë të mësimit të drejtpërdrejtë në klasë. Nxënësi zgjedh mënyrën e vet të mësimit sipas një orari të caktuar. Në këtë model nxënësi ka kontroll më shumë rreth të nxënit të tij. Mësuesi në këtë model luan rolin e monitoruesit dhe sqaron nxënësit për çdo paqartësi që ata kanë.



### Modeli virtual i pasuruar

Në këtë model nxënësit realizojnë pjesën më të madhe të punës online.

*Pavarësisht modeleve të ndryshme, esenca e mësimit të kombinuar është të kombinojë më të mirat e të dyja formave: arsimin tradicional, ku nxënësit mësojnë dhe kanë gjithë materialet për të mësuar në klasë dhe arsimin modern, ku nxënësit kanë mundësi të gjejnë material për të mësuar në internet ose me aplikacione të ndryshme.*

## Avantazhet e mësimit të kombinuar

Mësimi i kombinuar, si një metodë mësimore e cila përdor teknologjinë digjitale të kombinuar me mësimin e drejtpërdrejtë në klasë, kërkon përfshirjen e mësuesit edhe të nxënësve, duke u ofruar nxënësve një qasje të personalizuar për të nxënë. Mësimi i kombinuar është efektiv pasi nxënësit nuk janë vetëm dëgjues, por edhe veprues në procesin mësimor.

*Disa nga avantazhet e mësimit të kombinuar janë:*

- Mësimi i kombinuar është ideal për nxënësit me stile të ndryshme të të nxënit. Duke patur parasysh se nxënësit mësojnë në mënyra të ndryshme, mësimi i kombinuar mund të përmbushë nevojat e gjithësecilit. Duke kombinuar teknologjinë digjitale dhe mësimdhënien në klasë, nxënësit mund të punojnë në mënyrë të pavarur për të mësuar fjalor të ri e duke krijuar mundësi për mësuesin të ndihmojë nxënësit të cilët kërkojnë më shumë vëmendje.
- Mësimi i kombinuar si një mënyrë e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit ka përmirësuar qëndrimin e nxënësve ndaj të nxënit. Nxënësit janë më të përfshirë në procesin e të nxënit dhe kjo ndihmon në zgjerimin e ndërveprimit social.
- Mësimi i kombinuar krijon mundësi për një të nxënë më të personalizuar duke zëvendësuar modelin tradicional të mësimdhënies ku mësuesi qëndron përpara nxënësve dhe secili nga nxënësit duhet të rrijë në të njëjtin vend dhe të mbarojnë detyrat e dhëna në të njëjtën kohë. Mësimi i kombinuar, nëpërmjet modeleve të ndryshme, lejon nxënësit të punojnë me ritmin e tyre dhe të sigurohen që i kanë kuptuar konceptet e reja.
- Mësimi i kombinuar forcon dhe inkurajon autonominë e nxënësit. Në një orë mësimi ku mësuesi përdor mësimin e kombinuar, nxënësit tregojnë më shumë pavarësi në përmbushjen e detyrave të dhëna. Në kushte të tilla, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit të ndjehen të sigurtë në përdorimin e teknologjisë dhe të forcojnë ndjenjën e pavarësisë.



- Mësimi i kombinuar ofron fleksibilitet si për mësuesin, ashtu edhe për nxënësit. Mësuesi planifikon dhe vendos se si do ta trajtonte mësimin e ri dhe në varësi të modelit që mësuesi do të përdorë, nxënësit mund të aksesojnë materialet e mësimin në mënyrën më të përshtatshme për ta.
- Mësimi i kombinuar ndihmon nxënësit të përfshihen, stimulohen dhe argëtohen më shumë në orën e mësimin.
- Mësimi i kombinuar krijon mundësi për nxënësit të punojnë në ritmin e tyre. Nxënësit jo vetëm mësojnë në mënyra të ndryshme, por ata kanë edhe pika të forta ose dobësi të ndryshme. Në varësi të modelit të mësimin të kombinuar që përdor mësuesi, nxënësit mund të marrin informacionin që kanë nevojë pa e krahasuar veten me nxënësit e tjerë.

# Nga të fillojmë

Përdorimi i teknologjisë mbetet gjithmonë një sfidë për ju si mësues. Nëse nuk jeni të sigurtë në përdorimin e mjeteve të teknologjisë në klasë, ju nuk jeni vetëm. Shumica e mësuesve në botë ndihen në ankth se si mund ta përmirësojnë mësimdhënien për t'u përshtatur me nxënësit në këtë epokë digjitale.

Më poshtë po ju prezantojmë gjashtë këshilla të cilat mund t'ju ndihmojnë për të përmirësuar mësimdhënien tuaj duke përdorur teknologjinë.

**1**

*Jepuni nxënësve në grupe të vogla të eksplorojnë një mjet teknologjik dhe si mund të përdoret ai në orën e mësimit. Hapi i dytë do të jetë që secili grup të prezantojë para klasës mënyrat e përdorimit. Në këtë mënyrë mësojnë jo vetëm nxënësit e tjerë, por edhe ju si mësues.*

Gjatë kësaj veprimtarie shpjegojuni nxënësve hapat që duhet të ndjekin gjatë prezantimit dhe këshillojini të jenë të durueshëm dhe të përqipen të monitorojnë bashkëmoshatarët e tyre. Shpjegimet që japin nxënësit duhet të jenë të thjeshta për t'u kuptuar dhe mundësisht t'u jepet një format i cili duhet të ndiqet nga të gjithë përfaqësuesit e grupeve që do prezantojnë:

**1**

Së pari, klikoni në \_\_\_\_\_ . (p.sh. Projekti i ri)

**2**

Së dyti, shkoni në këndin e sipërm në të djathtë të ekranit dhe klikoni në \_\_\_\_\_ (Zgjidhni Sfondin)

**3**

Së treti, shikoni paraprakisht \_\_\_\_\_ . (Opsionet e sfondit)

**4**

Instruksonet vijuese. \_\_\_\_\_

Një tjetër mundësi është që të mësohet paraprakisht fjalori i nevojshëm dhe gjuha funksionale në mënyrë që nxënësit prezantues të mund të japin udhëzime të qarta. Kërkojuni nxënësve të përfshihen në stuhi mendimesh, duke përdorur të menduarit krijues dhe kritik rreth mënyrave më të mira për të hartuar udhëzime sa më të qarta për t'u kuptuar për mjetin teknologjik që ata do të prezantojnë.

Nuk duhet të habiteni nga emocioni dhe durimi që do të shfaqin nxënësit tuaj. Në fund të fundit, një koncept thelbësor për motivimin e nxënësve është, t'u ofrohen atyre aktivitete të përshtatshme. Për më tepër, përdorimi i metodës së zbulimit u jep nxënësve tuaj aftësinë dhe motivimin për të performuar mirë. Nëse disa nxënës hezitojnë, bashkoni ata me të tjerë që kanë më shumë vetëbesim ose krijoni grupe dhe caktoni role që lejojnë secilin pjesëmarrës të angazhohet dhe të kontribuojë si: prezantues, shkruar, kontrollues faktesh, matës kohe e kështu me radhë.



*Filloni me ato mjete teknologjike që ju interesojnë juve personalisht.*

Përzgjedhja e mjeteve teknologjike që paraqesin interes për ju, do t'ju motivojnë të mësoni dhe t'i përdorni ato gjatë procesit mësimor. Ekziston një numër i madh mjetesh teknologjike edukative-mësimore dhe shumica prej tyre ofrojnë versione falas. Angazhohuni për të gjetur mjetet tuaja të preferuara duke i provuar ato ose duke pyetur kolegët se cilat nga këto mjete preferojnë ata. Si fillim, përcaktoni se cili është rezultati i të nxënësve për orën e mësimin dhe më pas sigurohuni të zgjidhni atë mjet teknologjik i cili ndihmon për realizimin e rezultatit të të nxënësve. Përdorimi i teknologjisë vetëm "për argëtim" mund të jetë shpenzim kohe për ju dhe nxënësit tuaj. Kini parasysh se, nëse konsideroni një mjet potencialisht të dobishëm, mund t'ju duhet kohë për ta zotëruar atë.



*Mos prisni të kuptoni gjithçka menjëherë në lidhje me mjetin teknologjik që dëshironi të përdorni.*

Si fillim, eksperimentoni me mjetin teknologjik që keni dëshirë të përdorni. Gradualisht, do të kuptoni se si mund ta përdorni më së miri. Mjetet digjitale kanë shumë përdorime dhe krijuesit po shtojnë vazhdimisht mundësi dhe burime të tjera. Në përgjithësi, mjetet e teknologjisë me cilësi të lartë, ofrojnë video tutoriale falas, buletine dhe ekipe shërbimi që përgjigjen menjëherë dhe me mirësjellje, pavarësisht se ku mund të jetë përdoruesi. Ekipet e shërbimit nuk i japin rëndësi nëse përdorni versione falas ose me pagesë. Në fakt, ata shpesh dërgojnë me email trajnime dhe këshilla falas, në mënyrë që përdoruesit të përfitojnë sa më shumë nga mjete dhe t'u tregojnë të tjerëve për të. Shumë prej tyre kanë manuale online, disa janë në më shumë se një gjuhë. Ju mund të kërkoni dhe shikoni mësim falas në YouTube. Teknikë me përvojë dhe ekspertë në teknologji postojnë burime të shkëlqyera se si të përdoren këto mjete digjitale.



*Merrni pjesë në webinar-e që mbështesin përdorimin e teknologjisë në klasë.*

Mësuesit e gjuhës angleze mund të hyjnë në faqen [www.FutureLearn.com](http://www.FutureLearn.com), e cila ofron kurse online falas, për të ndihmuar mësuesit e gjuhës angleze të përmirësojnë mësimdhënien e tyre nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.

Departamenti Amerikan i Shtetit gjithashtu ofron webinar-e dhe burime të tjera për mësuesit e gjuhës angleze në <https://americanenglish.state.gov>. Kjo faqe jo vetëm është një qendër burimore për të mësuar rreth gjuhës dhe kulturës angleze amerikane, por gjithashtu ofron një shumëllojshmëri materialesh dhe burimesh tërheqëse për zhvillimin profesional të mësuesve dhe për nxënësit në klasë. Mësuesit dhe nxënësit mund të gjejnë mënyra të reja për të praktikuar anglishten dhe për të mësuar më shumë për Shtetet e Bashkuara.

Mësuesit e gjuhës angleze gjithashtu mund të përdorin faqen e Këshillit Britanik <https://www.teachingenglish.org.uk/>, ku mund të gjejnë informacion për ngritjen e tyre profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe informacionit që ofrohet në këtë faqe.

### **5** *Lexoni për tendencat e fundit në zhvillimin e teknologjive të mësimdhënies.*

Asnjëherë mos ndaloni së lexuari rreth tendecave të fundit në fushën e teknologjisë në mësimdhënie. Çdo aplikacion i ri që del, gjithmonë shoqërohet me video tutoriale të cilat mund t'i gjeni në YouTube.

### **6** *Krijoni grupin tuaj mbështetës ose "grupin e teknikëve".*

Si mësues i gjuhës së huaj mund të krijoni një grup mbështetës të krijuar nga vetë nxënësit të cilët kanë njohuri të mira teknologjike dhe mund t'ju vinë në ndihmë në momentet që ju keni nevojë. Gjithashtu, ju mund të gjeni teknikë në Twitter ose faqe të tjera sociale që ofrojnë shërbime falas. Ndonjëherë, vetëm komunikimi me këta njerëz, mjafton për t'ju motivuar të vazhdoni të praktikoni dhe të zbuloni se si të përdorni një mjet të caktuar teknologjik. Ju mund të merrni mbështetje emocionale dhe teknologjike nga teknikët, së bashku me këshilla rreth mjeteve të tjera që mund të dëshironi të përfshini në punën tuaj.

# Mjete teknologjike për përdorim

## Akelius

**Akelius**

**Funksionet kryesore:** Mësim i gjuhëve të huaja

**Përshkrimi:** Akelius është një platform digjitale për mësimin e gjuhëve të huaja. Kjo platformë ofron multimedia të pasur interaktive me materiale autentike si video, audio, grafikë vizuale, këngë, lojra duke e pajisur nxënësit me një përmbajtje kuptimplotë dhe në përputhje me interesat dhe nevojat e moshës. Kjo platformë ndihmon nxënësit të thellojnë dhe forcojnë njohuritë gjuhësore, të pasurojnë fjalorin e gjuhës së huaj të cilën janë duke mësuar, si dhe të argëtohen në kohën që janë duke mësuar.

Përmbajtja e pasur dhe interaktive përbën një nga elementët më të rëndësishëm të cilët ndihmojnë në motivimin e nxënësit dhe mësuesit për të hartuar orë mësimore që i përgjigjen të gjitha stileve të të nxënit.

**Vlerësimi:** Platformë digjitale shumë e thjeshtë për t'u përdorur dhe ka si prioritet të kuptuarin praktik të gjuhës dhe komunikimin. Në platformën Akelius, nxënësit mund të zgjedhë komponentët që ai dëshiron dhe ka nevojë, me ritmin që ai dëshiron dhe mund të kthehet prapa sa herë të dojë për të rifreskuar njohuritë para se të marrë njohuri të reja. Platforma bazohet në pedagogji digjitale moderne dhe është e thjeshtë pa terminologji ose udhëzime gramatikore të pakuptueshme.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://languages.akelius.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale, në grup ose në çift

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të lexuarit, Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht, Frëngjisht, Italisht, Gjermanisht etj.

language > English



≡ Akelius



Taal > English > A0





## Write & Improve

**Funksionet kryesore:** Planifikim lëndor

**Përshkrimi:** Write & Improve është një mjet online falas i zhvilluar nga Universiteti i Kembrixhit për të ndihmuar nxënësit e gjuhës angleze të përmirësojnë aftësitë e tyre të shkruarit. Nxënësit zgjedhin nivelin gjuhësor të tyre dhe në bazë të këtij niveli ju shfaqen detyra që mund të realizojnë. Pasi të jetë dorëzuar detyra, mjeti cakton automatikisht një notë të përshtatshme dhe gjithashtu jep komente për detyrën e realizuar. Nxënësit gjithashtu mund të krijojnë detyrat e tyre me shkrim në këtë faqe.

**Vlerësimi:** Write & Improve është një mjet shumë i dobishëm sepse u mundëson nxënësve të gjuhës angleze të praktikojnë aftësitë e tyre të përgjithshme gramatikore, fjalorin dhe të shkruarin në mënyrë të pavarur, kudo dhe në çdo kohë, pa praninë fizike të një mësuesi. Ky mjet u ofron nxënësve qindra detyra të ndryshme me shkrim në nivele të ndryshme të CEFR-së. Pas marrjes së feedback-ut për shkrimet e tyre, nxënësit mund të modifikojnë punën e tyre origjinale dhe ta ri-paraqesin atë për të parë sesi ndryshimet e rekomanduara kanë përmirësuar cilësinë e shkrimit të tyre.

**Çmimi:** Falas për nxënësit. Për mësuesit dhe institucionet, ka një periudhë prove falas prej 2 muajsh, duke lejuar maksimumi 200 nxënës të vlerësojnë këtë mjet përpara se të blihet një licensë.


**Website (Faqja e internetit):** <https://writeandimprove.com>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale



## Aftësitë gjuhësore që zhvillohen: Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht, Spanjisht



[Home](#)
[Learners](#)
[Teachers & Organisations](#)
[The CEFR](#)
[Help](#)

Language

[Sign in](#)



Create a profile


## Write & Improve

Developed by the University of Cambridge, Write & Improve is a FREE tool that helps every learner to improve their English writing.

- ✓ Choose from hundreds of tasks at all levels and start writing, or create your own tasks
- ✓ Submit your writing and get a result linked to the international standard, the [CEFR](#)
- ✓ Get automatic feedback on where your writing may need improvement
- ✓ Make changes and check again to improve your writing

Start writing



[Twitter](#)
[Facebook](#)

[→ Sign in](#)

Create profile

[Create profile](#)

W&I workbooks

- W&I Beginner
- W&I Intermediate
- W&I Advanced
- W&I Business
- W&I Just for fun!
- + 1 new task

+ Test Zone

- IELTS Academic
- IELTS General Training
- B2 First

[Create a workbook](#)

### W&I Beginner More tasks

- A note: Art class**  
 Read this email from your English friend, Sam.  
  
*I'd like to know more about the art course you did. How many people*
- Write sentences to answer the questions: about your free time**
  - What do you do in your free time? How often do you do it?
  - What do you like about that activity and why?
  - Tell us about the last film you did this
- An email: A visit from a friend**  
 Your friend Sam is coming to your house tomorrow evening.  
  
*Write an email to Sam.*
- A note: A school trip**  
 Write a note to a friend describing your favorite school trip. Make sure to tell them:

### W&I Intermediate More tasks

- An article: Films**  
 You see this announcement on an English-language website for young people.
- An application letter: Join our band!**  
 You see this notice on an English-language website.  
  
*Interested in music?*
- An opinion essay: Space exploration**  
 You have had a class discussion on space exploration. Now your teacher has asked you to write a composition answering the following question:
- An email: An English class project**  
 Read this email from your English-speaking friend Bryn and the notes you have made.

### W&I Advanced More tasks

### W&I Business More tasks

14

# factile

## Factile

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Factile është një platformë online që lejon mësuesit të krijojnë lojëra në mënyrë që të kontrollojnë përparimin e nxënësve dhe të shikojnë paraprakisht ose rishikojnë materialet mësimore. Ky është një version falas. Mësuesit ose mund të krijojnë vetë një kuiz, ose mund të zgjedhin një nga mijëra lojërat e përgatitura paraprakisht. Kur luhet loja, mësuesi klikon saktë ose gabim. Factile mund të përdoret për mësim në distancë dhe/ose mësimin e drejtpërdrejtë në klasë.

**Vlerësimi:** Factile është një mjet i thjeshtë për t'u përdorur nga mësuesit dhe nxënësit duke e integruar lehtësisht në çdo orë mësimi. Orët e mësimit bëhen më tërheqëse dhe argëtuese, ndërkohë që Factile ndihmon mësuesit të vlerësojnë nxënësit nëse i kanë kuptuar temat e vjetra dhe të reja. Për më tepër, Factile është i disponueshëm në disa gjuhë. Versioni falas lejon vetëm krijimin e lojëra të stilit të rrezikshëm, ndërsa lojërat si: me mundësi të ndryshme, modeli i sinjalizimit, zgjedhje e shumëfishtë, kuize apo lojërat me kujtesën janë me pagesë.


**Çmimi:** Falas (Plani Premium është i disponueshëm)

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.playfactile.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të folurit, Të shkruarit, Fjalori

**Gjuha:** Anglisht, Spanjisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Kineze, Arabe



**factice** Home Features Plans Support Sign Up Log In English

**Create an online Jeopardy-style quiz game board in minutes**

Now with Buzzer Mode – for in the classroom and for remote learning

[SIGN UP](#)  
SIGN UP FOR FREE

[SIGN IN](#)

Factice is the #1 Jeopardy-style classroom quiz review game! Learn why Factice is played by the best, and get started now for free!

- ✓ Create your own game in minutes
- ✓ Search from thousands of premade game templates
- ✓ Play Jeopardy-style, Multiple Choice, or as Classic Memory games
- ✓ Use and share online flashcards
- ✓ Play from your computer, tablet or phone
- ✓ Users "buzz-in" for a fun and engaging classroom experience
- ✓ New – Remote / Distance learning, including Remote Buzzer Mode





**Public Games** Search Games... Browse All Games


**GEOGRAPHY JEOPARDY**

CONTINENTS	OCEANS	RIVERS	PRESIDENTS	CLIMATE	MAPS
\$100	\$100	\$100	\$100	\$100	\$100
\$200	\$200	\$200	\$200	\$200	\$200
\$300	\$300	\$300	\$300	\$300	\$300
\$400	\$400	\$400	\$400	\$400	\$400
\$500	\$500	\$500	\$500	\$500	\$500

It's free, easy and loads of fun!

[Play Demo Game](#)

 \$0 PENGUIN  
 \$0 RHINO  
 \$0 PINEAPPLE  
 \$0 GIRAFFE



**Factice is a free learning platform that lets teachers create engaging jeopardy-style quiz games for the remote or in-person classroom**

Assess students' understanding of new topics or review the latest concepts using our simple, user-friendly gameboard template. Create and share your games with students, or search our database of already-created games. Use Factice with Google Classroom to easily assign games and flashcards to your class.


[Play Demo Game](#)

[Get started for free >](#)

**Over 2 Million Games and counting!**

[Try Now](#)

World Geography 1	Game	Flashcards
World Geography 2	Game	Flashcards
Cell Biology	Game	Flashcards
Elementary Math	Game	Flashcards
All About Sharks	Game	Flashcards



**Funksionet kryesore:** Organizues grafikësh; Marrje shënimesh

**Përshkrimi:** Plectica është një mjet online i cili ndihmon për të krijuar harta të koncepteve dhe diagrama. Plectica është shumë i thjeshtë për t'u përdorur dhe lejon mësuesit dhe nxënësit të organizojnë dhe shpërndajnë informacionin me lehtësi. Hartat e koncepteve dhe diagramet mund të përdoren individualisht ose të shpërndahen dhe të punohen në bashkëpunim me të tjerë. Informacioni mund të organizohet në një listë, kolona ose si tekst dhe mund të zhvendoset lehtësisht vetëm duke tërhequr kursorin. Nxënësit mund t'i lidhin figurat me njëra-tjetrën me një shigjetë. Të gjitha ndryshimet ruhen automatikisht.

**Vlerësimi:** Mjet i shkëlqyeshëm për stuhi mendimesh në një klasë kur punohet si me grupe të mëdha ashtu dhe me grupe më të vogla. Ky mjet i lejon nxënësit të ndryshojnë llojin e shkrimit, ngjyrat si edhe të shtojnë komente, shënime, imazhe e media të tjera.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas (Plani premium është i disponueshëm)

**Website (Faqja e internetit):** <https://beta.plectica.com/>




**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit, Fjalori

# Gjuha: Anglisht

Empathy Map · TV purchase

Share 99





## Ayoo

**Funksionet kryesore:** Planifikim lëndor; krijim harta të koncepteve, tabelë interaktive

**Përshkrimi:** Ayoo është një platformë digjitale që ofron tre mjete të ndryshme të cilat mund të lidhen në mënyra fleksibël: hartat e koncepteve, një tabelë detyrash dhe një tabelë interaktive. Qasja vizuale dhe funksionet e saj të filtrit mund të jenë veçanërisht të dobishme për të punuar me grupe të ndryshme. Nxënësit mund të krijojnë harta të koncepteve ndërvepruese për stuhi mendimesh, mund të ndryshojnë ngjyrat e sfondit dhe të bëjnë ndryshime të hartave si dokumente dhe imazhe në Word ose Pdf. Mësuesit dhe nxënësit mund të krijojnë gjithashtu lista detyrash të orientuara nga koha që mund të ndahen në tre kategori (tani, tjetër, së shpejti). Në tabelën interaktive, mësuesit dhe nxënësit mund të shtojnë përmbajtje interaktive, të tilla si shënime me ngjitje, lista kontrolli, grafikët rrjedhës ose imazhe. Ayoo gjithashtu lejon nxënësit të caktojnë vetë detyrat e tyre.

**Vlerësimi:** Ayoo është një mjet digjital i lehtë për t'u përdorur në krijimin e hartave të koncepteve, si dhe në manaxhimin e klasës apo të projekteve të ndryshme. Mund të jetë shumë i dobishëm për stuhi idesh në punën me grupe.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas (*Plani premium është i disponueshëm*)

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.ayoo.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen: Të shkruarit**

**Gjuha:** Anglisht




Home Products Neurodiversity Resources Pricing  EN • Log In

## Be different, work visually

Try the world's most visual productivity app. Supercharge thinking, planning and learning with AI, mind maps, task boards, and more

Enter your email  [Get started](#)




## The world's only mind maps with AI

Use one of the largest deep learning networks ever created to generate unique and innovative ideas for **anything you can think of**.

- ✓ Ask the right questions
- ✓ Breeze past blocks
- ✓ Explore new angles
- ✓ Unlock problems
- ✓ Mind map in full flow

Take your mind maps to the next level using AI.  
\*Available in **Ayoa Ultimate** only.

[Find out more](#)





## Hero Forge

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Hero Forge është një krijues avatar dhe i thjeshtë për t'u përdorur. Ky mjet i lejon mësuesit dhe nxënësit të shfrytëzojnë krijimtarinë e tyre duke vizatuar personazhe virtuale që mund të përdoren në veprimtaritë mësimore. Falë veçorive të shumta të Hero Forge dhe teknologjisë 3D, nxënësit do të jenë në gjendje të zgjedhin llojin dhe gjininë e avatarit të tyre, së bashku me ngjyrën e flokëve, syve dhe shumë më tepër.

**Vlerësimi:** Hero Forge është një mjet shumë interesant që i bën orët mësimore më krijuese dhe më tërheqëse. Orët e mësimit të gjuhës së huaj bëhen më përfshirëse dhe argëtuese kur përdoret Hero Forge, pasi mësuesi dhe nxënësit mund të integrojnë lehtësisht krijimin e personazheve të ndryshëm në tema të tilla si lufta kundër ndryshimeve klimatike, qytetërimet e lashta të botës, etj. Për më tepër, krijimi i avatarëve me Hero Forge është plotësisht falas dhe mjeti lejon që nxënësit t'i ruajnë heronjtë e krijuar dhe t'i ndajnë ato me të tjerët. Nxënësit mund të blejnë avatarët e tyre në versionin plastik 3D ose prej bronzi për një tarifë të caktuar, megjithëse kjo është një veçori që shumica e mësuesve dhe nxënësve nuk do të jenë të interesuar ta përdorin.

**Çmimi:** Falas (*Plani premium është i disponueshëm*)



**Website (Faqja e internetit):** <https://www.heroforge.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale, prezantime (p.sh. ligjërata, tregime)



**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të folurit, Të lexuarit, Fjalori

**Gjuha:** Anglisht



# Pitch

## Pitch

**Funksionet kryesore:** Prezantim me slajde

**Përshkrimi:** Pitch është një mjet për të krijuar prezantime interaktive. Pitch ofron modele (shablone) dhe stile tërheqëse për nxënësit për të punuar individualisht ose në grup. Mësuesit dhe nxënësit mund të shtojnë afate kohore, grafikë (këto mund të importohen nga Google Sheets dhe Google Analytics), ikona, ngjitëse, imazhe, etj. Anëtarët e grupit janë në gjendje të lidhin kamerat e tyre dhe të komunikojnë gjatë prezantimit. Nxënësit mund t'ju caktojnë slajde anëtarëve të tjerë të grupit, t'u shtojnë statuset e slajdeve rreth fazave të ndryshme në të cilat ndodhen (për shembull: "për të bërë", "në zhvillim" ose "mbaruar"), të shkruajnë komente, të shtojnë reagime, të lënë shënime tek prezantimi, të ndajnë prezantimin dhe të ftojnë anëtarët e tjerë gjithashtu.

**Vlerësimi:** Pitch është një mjet prezantimi i thjeshtë për t'u përdorur i cili ofron shumë mundësi redaktimi. Ai është veçanërisht i përshtatshëm për mësuesit dhe nxënësit që duan t'i japin një pamje të re prezantimeve të tyre në klasë. Pitch është perfekt për punën në grup.


**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas (*Plani premium është i disponueshëm*)

**Website (Faqja e internetit):** <https://pitch.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale, prezantime (p.sh. ligjërata, tregime)

## Aftësitë gjuhësore që zhvillohen: Të shkruarit, Fjalori

**Gjuha:** Anglisht



### Make edits fast

Unleash your inner designer. Intuitive editing options and smart formatting help anyone feel like a power user.

### Browse millions of images

### Add rich media

### Integrate data





## AgoraQuiz

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** AgoraQuiz është një mjet digjital edukativ online që lejon mësuesit të krijojnë kuize për nxënësit që të punojnë në grupe. Kjo do të thotë që, pasi të regjistrohen, mësuesit duhet të krijojnë një grup për nxënësit e tyre, si dhe tema për t'u praktikuar: për shembull, artet, shkencat ose matematika. Më pas nxënësit shkruajnë pyetje për temën e caktuar të cilat rishikohen më vonë nga mësuesi, i cili krijon një kuiz me pyetjet e zgjedhura. Në fund, nxënësit konkurojnë me njëri-tjetrin për të parë se kush jep më shumë përgjigje të sakta pyetjeve të bëra.

**Vlerësimi:** AgoraQuiz është një mjet digjital që u jep nxënësve mundësinë për të mësuar në mënyrë argëtuese dhe motivuese. Ata mësojnë si gjatë krijimit të pyetjeve ashtu dhe kur luajnë me njëri-tjetrin. Përveç kësaj, AgoraQuiz i lejon mësuesit të monitorojnë jo vetëm të gjithë klasën por edhe secilin prej nxënësve në mënyrë që të identifikojnë vështirësitë individuale ose të grupit. AgoraQuiz është veçanërisht i përshtatshëm për klasat e nivelit më të lartë ose nxënësit me një nivel të mirë të gjuhës frënge, pasi faqja aktualisht është e disponueshme vetëm në këtë gjuhë.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://agora-quiz.education/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

## Aftësitë gjuhësore që zhvillohen: Të lexuarit, Të shkruarit, Fjalori

**Gjuha:** Frëngjisht



Comment ça fonctionne ? Points forts Témoignages A propos Contact [Inscription](#) [Connexion](#)


**Un outil pédagogique ludique pour créer des quiz collaboratifs.**

Sur des thèmes choisis, les Élèves proposent des questions que l'Enseignant valide avant d'ouvrir la phase de jeu.

[Inscription](#) [Connexion](#)

**Découvrir AgoraQuiz**

En Savoir Plus



Accueil du Groupe [Jouer](#) [Admin](#)

Test : Culture Gén... **Thèmes du Groupe**  
Test : Culture Générale

11 / 12 Thème(s) en Jeu

Mettre tous les Thèmes en Jeu

+	<b>Musique</b> 375 Questions validées	<b>Géographie / Politique</b> 372 Questions validées	<b>Langues / Littérature</b> 330 Questions validées	<b>Cinéma et Séries TV</b> 279 Questions validées
	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>
Ajouter un Thème	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>
<b>Culture Geek</b> 235 Questions validées	<b>Histoire et Mythologie</b> 231 Questions validées	<b>Sport</b> 215 Questions validées	<b>Faune et Flore</b> 189 Questions validées	<b>Sciences</b> 89 Questions validées
Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>
Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>
<b>Art</b> 88 Questions validées	<b>L'Éducation Nationale</b> 34 Questions validées	<b>Nourriture / Boissons</b> 25 Questions validées		
Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>	Thème en Jeu <input checked="" type="checkbox"/>		
Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>	Ajout de Questions <input checked="" type="checkbox"/>		

# WHITEBOARD.fi

## Whiteboard.fi

**Funksionet kryesore:** Planifikim lëndor

**Përshkrimi:** Whiteboard.fi është një mjet digjital online që përdoret si tabelë interaktive në klasë ose gjatë mësimit në distancë. Çdo nxënës, me kodin e klasës, ka një tabletë ku mund të vizatojë, të shkruajë një tekst ose të bëjë shënime. Mësuesi është në gjendje të shohë të gjitha tabletat e nxënësve në kohë reale dhe të ndjekë përparimin e tyre. Nxënësit shohin vetëm tabelën interaktive të mësuesit.

**Vlerësimi:** Whiteboard.fi wshtw shumë e thjeshtë për t'u përdorur nga mësuesit, për t' u lidhur me nxënësit gjatë orëve të mësimit në distancë dhe për t'i bërë orët e mësimit më interaktive. Një pengesë është se versioni falas nuk lejon të ruhen ose të ripërdoren materialet e tabletave dhe as të ruhen skedarë PDF.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://whiteboard.fi/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht



## Puzzlemaker

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Puzzlemaker është një mjet digjital që ju vjen në ndihmë mësuesve dhe nxënësve për të krijuar pazëlla. Me këtë mjet mund të krijohen dhe të printohen kërkime fjalësh, kryqëzime, pazëlla matematikore dhe shumë të tjera. Është shumë i shpejtë dhe i lehtë për t'u përdorur. Mësuesit mund të krijojnë lista fjalësh ose të prisin dhe ngjisin një tekst në Puzzlemaker për të gjeneruar llojin e zgjedhur të pazëllit.

**Vlerësimi:** Puzzlemaker është një gjenerues i thjeshtë, por efektiv i pazëllave. Puzzlemaker ofron një shumëllojshmëri mënyrash për t'i krijuar ato, duke i dhënë mundësi mësuesit dhe nxënësit të bëjnë aktivitete argëtuese. Nxënësit kanë mundësinë për të zgjedhur nivelin e pazëllit, të lehtë ose të vështirë. Nuk ka nevojë për nxënësit dhe mësuesit të regjistrohen në faqe. Është e rëndësishme për mësuesit të shkarkojnë menjëherë pazëllat që krijojnë në mënyrë që të mos i humbasin ato.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://puzzlemaker.discoveryeducation.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit, Fjalori

**Gjuha:** Anglisht

**Funksionet kryesore:** Rrëfim historish dhe tregimesh

**Përshkrimi:** Storyjumper është një faqe interneti që u ofron mësuesve dhe nxënësve mundësinë për të krijuar librat e tyre digjital. Mësuesit kanë mundësinë për të krijuar një model (shabllon), të cilin nxënësit mund ta përdorin. Nxënësit mund të shkruajnë dhe krijojnë historitë e tyre duke shtuar tekste, personazhe, imazhe dhe sfonde. Ata mund të ngarkojnë imazhet e tyre ose të përdorin ato të cilat ofrohen nga faqja e internetit. Nxënësit gjithashtu mund të bëjnë regjistrime zanore ose të shtojnë muzikë në sfond për të shoqëruar historitë e tyre. Ndryshimet në libër ruhen automatikisht. Nxënësit mund të punojnë së bashku në të njëjtin libër.

**Vlerësimi:** Storyjumper është një mënyrë interaktive, krijuese dhe argëtuese për të motivuar nxënësit të praktikojnë aftësitë e tyre të shkruarit dhe të shqiptimit. Është një mjet i dobishëm për punën me projekte ose për të mbështetur bashkëpunimin midis nxënësve.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.storyjumper.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale, prezantime (p.sh. ligjërata, tregime)

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht





## WordArt

**Funksionet kryesore:** Krijues reje me fjalë

**Përshkrimi:** WordArt është një krijues i reve me fjalë i cili lejon krijimin unik dhe argëtues të reve të fjalëve. WordArt është i përshtatshëm për nxënësit dhe i personalizueshëm. Nxënësit mund të eksperimentojnë me forma, ngjyra dhe vizatime të ndryshme. Fjala e parë që shkruhet në listën e hyrjes së fjalëve do të jetë fjala më e madhe në re, pastaj e dyta, etj. Ky mjet përcakton madhësinë e fjalës me frekuenca, ndryshe nga mjetet e tjera të këtij lloji.

**Vlerësimi:** Ky është një mjet i dobishëm për të mbledhur fjalë për një temë të caktuar ose për t'i bërë nxënësit të punojnë me fjalorin. Mësuesi përcakton se cilat fjalë do të jenë më të mëdha sipas renditjes që i vendos fjalët. Në WordArt mësuesi ka kontroll mbi pamjen, por jo për shfaqjen e fjalëve sipas frekuencës së tyre. Ekziston një version premium për shkarkimin e imazheve me cilësi profesionale nga WordArt, por ai nuk është i nevojshëm për përdorim në klasë.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas *(Plani premium është i disponueshëm)*

**Website (Faqja e internetit):** <https://wordart.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale.

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht

**LIVRESQ**

**Funksionet kryesore:** Planifikim lëndor

**Përshkrimi:** LIVRESQ është një mjet online me modele (shabllone) ku mësuesit mund të krijojnë orë mësimore në distancë dhe mësimet interaktive. Mësuesit mund të vendosin të përdorin modele (shabllone) të LIVRESQ ose të krijojnë modelet e tyre nga e para duke e bërë të gjithë përmbajtjen 100% të personalizueshme dhe të përshtatshme për nxënësit e tyre.

**Vlerësimi:** LIVRESQ lejon krijimin e materiale mësimore interaktive dhe profesionale për t'i bërë mësimet më argëtuese dhe të përshtatshme për nxënësit. Ai gjithashtu shquhet për faqen e tij të thjeshtë dhe intuitive. LIVRESQ ofron një mënyrë të lehtë për mësuesit për të krijuar burime në internet pa pasur nevojë për programim.

**Çmimi:** Falas për mësuesit (rinovim vjetor)

**Website (Faqja e internetit):** <https://livresq.com/en/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale.

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Rumanisht, Anglisht, Portugalisht, Kineze, Arabe dhe Koreane



## Wordwall

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Wordwall është një mjet digjital për krijimin e aktiviteteve mësimore. Me këtë mjet, mësuesit mund të vendosin temën që dëshirojnë të trajtojnë në Wordwall dhe të marrin një sërë aktiviteteve të gatshme, plotësisht të personalizueshme si kuize, lojëra fjalësh, lojëra me labirinte etj. Ata gjithashtu mund të krijojnë aktivitetin nga fillimi. Për më tepër, shumica e aktiviteteve në Wordwall mund të përdoren si në formate interaktive ashtu edhe në ato të printueshme.

**Vlerësimi:** Wordwall është një mjet i shpejtë dhe i lehtë për t'u përdorur dhe për të krijuar aktivitete ndërvepruese në orën e mësimit. Ky mjet ofron një gamë të gjerë aktiviteteve për t'u zgjedhur dhe e bën të mësuarit shumë më argëtues. Për më tepër, ai është i disponueshëm në shumë gjuhë të ndryshme. Një pengesë është se me llogarinë falas mund të krijohen vetëm deri në 5 lloje aktiviteteve. Pas kësaj, do të duhet të fshihen aktivitetet për të krijuar të reja.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://wordwall.net/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale, prezantim (p.sh. leksione, tregime)

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të lexuarit, Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** I disponueshëm në më shumë se 20 gjuhë



## Narakeet

**Funksionet kryesore:** Regjistrimi, redaktimi dhe shpërndarja e videove

**Përshkrimi:** Narakeet është një mjet digjital për krijimin e prezantimeve me video dhe me zë. Mësuesit ose nxënësit mund të ngarkojnë PPT (prezantim Power Point) ose tekst (skript) dhe Narakeet i transformon këto prezantime në video. Për më tepër, ai bën të gjithë punën e vështirë, si regjistrimin e zërit ose sinkronizimin e zërit dhe imazhit. Është shumë i thjeshtë për t'u përdorur.

**Vlerësimi:** Narakeet është një mjet shumë i dobishëm dhe i thjeshtë për t'u përdorur që u mundëson mësuesve të transformojnë prezantimet e tyre në video, duke i lejuar ata gjithashtu të shtojnë rrëfim ose muzikë në sfond. E bën mësimin nga distanca më të lehtë dhe ka mbi 120 lloje tingujsh dhe më shumë se 25 gjuhë.

**Çmimi:** Falas (më shumë mundësi kur regjistroheni)

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.narakeet.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit

**Gjuha:** Anglisht



## Narakeet

**Funksionet kryesore:** Regjistrimi, redaktimi dhe shpërndarja e videove

**Përshkrimi:** Narakeet është një mjet digjital për krijimin e prezantimeve me video dhe me zë. Mësuesit ose nxënësit mund të ngarkojnë PPT (prezantim Power Point) ose tekst (skript) dhe Narakeet i transformon këto prezantime në video. Për më tepër, ai bën të gjithë punën e vështirë, si regjistrimin e zërit ose sinkronizimin e zërit dhe imazhit. Është shumë i thjeshtë për t'u përdorur.

**Vlerësimi:** Narakeet është një mjet shumë i dobishëm dhe i thjeshtë për t'u përdorur që u mundëson mësuesve të transformojnë prezantimet e tyre në video, duke i lejuar ata gjithashtu të shtojnë rrëfim ose muzikë në sfond. E bën mësimin nga distanca më të lehtë dhe ka mbi 120 lloje tingujsh dhe më shumë se 25 gjuhë.

**Çmimi:** Falas (më shumë mundësi kur regjistroheni)

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.narakeet.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit

**Gjuha:** Anglisht



## Screenpresso

**Funksionet kryesore:** Fotografimi i ekranit

**Përshkrimi:** Screenpresso është një aplikacion falas që lejon fotografimin e të gjithë ekranit të kompjuterit ose të zonave të caktuara si edhe modifikimin e tyre në mënyrë që t'i përdoren për të krijuar shpjegime me imazhe dhe/ose video. Mësuesit ose nxënësit thjesht duhet që të shkarkojnë aplikacionin për të qenë në gjendje të fotografojnë atë që dëshirojnë.

**Vlerësimi:** Screenpresso ka një ndërfaqe shumë të thjeshtë dhe është një mjet i shkëlqyeshëm për mësuesit që ta përdorin kur përpiqen t'u shpjegojnë diçka nxënësve të tyre në një mënyrë më vizuale. Është i disponueshëm në shumë gjuhë. E vetmja pengesë është se është i përshtatshëm vetëm për Windows.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.screenpresso.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të folurit

**Gjuha:** I disponueshëm në më shumë se 15 gjuhë



## CryptPad

**Funksionet kryesore:** Shpërndarja/sinkronizimi i skedarëve, Prezantimi i slajdeve

**Përshkrimi:** CryptPad është një redaktues falas i dokumenteve të përbashkëta me burim të hapur si tekste të pasura, sondazhe, tabela interaktive dhe prezantime. Një nga avantazhet kryesore të këtij mjeti është se shpërndarja e një dokumenti është po aq e thjeshtë sa marrja e URL-së që mund të shpërndahet. Për më tepër, sistemi i të biseduarit online lejon redaktorë të ndryshëm të flasnin me njëri-tjetrin në kohë reale. CryptPad është një mjet i shkëlqyeshëm për nxënësit që punojnë në grup. Rregjistrimi në CryptPad nuk është i domosdoshëm për ta përdorur, por jep akses në më shumë mundësi për përdorim.

**Vlerësimi:** Edhe pse CryptPad është shumë i ngjashëm me mjetet e Microsoft si Word ose PowerPoint, ky aplikacion me burim të hapur lejon një mjedis më bashkëpunues, ndërkohë që i mban të dhënat private. E gjithë përmbajtja kodohet dhe dekodohet nga nxënësit e një grupi, që do të thotë se askush jashtë grupit nuk ka akses në informacion. Mjeti është i disponueshëm në shumë gjuhë.


**Çmimi:** Falas (më shumë mundësi nëse regjistroheni)

**Website (Faqja e internetit):** <https://cryptpad.fr/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

## Aftësitë gjuhësore që zhvillohen: Të shkruarit

**Gjuha:** I disponueshëm në 13 gjuhë







## Excalidraw

**Funksionet kryesore:** Planifikim lëndor

**Përshkrimi:** Excalidraw është një mjet digjital i tabelës interaktive që lejon mësuesit dhe nxënësit të krijojnë lehtësisht harta konceptuale dhe diagrama. Ata mund të shtojnë forma të ndryshme, të ndryshojnë ngjyrat e tyre dhe të shkruajnë tekste. Nxënësit mund të ftojnë edhe shokë të tjerë që të punojnë së bashku në të njëjtën tabelë. Ata mund të shkarkojnë tabelën e përfunduar si një skedar imazhi.

**Vlerësimi:** Një mjet i shkëlqyeshëm për t'u përdorur në klasë si një tabelë virtuale. Është një mjet bashkëpunues, i përshtatshëm dhe shumë praktik për nxënësit për të hedhur ide spontane/ rrahje mendimesh.

**Çmimi:** Falas pa regjistrim (*Plani premium është i disponueshëm*)

**Website (Faqja e internetit):** <https://excalidraw.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Spanjisht, Italisht, etj.



## Skribbl

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Skribbl është një lojë falas e tipit "Vizato dhe hamendëso" në internet për të praktikuar fjalorin dhe aftësitë e të vizatuarit. Në këtë lojë, ka gjithmonë një lojtar që është përgjegjës për të ilustruar me vizatim një nga fjalët e ofruara nga serveri (nga 3 lloje që jepen gjithsej). Nxënësit e tjerë duhet të hamendësojnë se çfarë po vizaton shoku i tyre për të fituar pikë. Fituesi është nxënësi që ka më shumë pikë në fund të raundit. Nxënësit mund të luajnë në një grup deri në 12 persona.

**Vlerësimi:** Skribbl është një lojë shumë argëtuese për nxënësit që të praktikojnë fjalorin dhe të zhvillojnë krijimtarinë e tyre. Kjo lojë gjithashtu i ndihmon ata të zhvillojnë imagjinatën dhe aftësitë e tyre të manaxhimit të kohës. Ndërfaqja (interface) është shumë e thjeshtë për t'u përdorur dhe është e disponueshme në më shumë se 20 gjuhë. E vetmja pengesë është se në një dhomë private mund të ketë vetëm deri në 12 lojtarë.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://skribbl.io/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit, Fjalori

**Gjuha:** I disponueshëm në më shumë se 20 gjuhë

 **OpenBoard****OpenBoard**

**Funksionet kryesore:** Planifikim lëndor

**Përshkrimi:** OpenBoard është një tabelë interaktive e krijuar kryesisht për përdorim në shkolla dhe universitete. Ajo i lejon mësuesit të krijojnë përmbajtje të drejtpërdrejtë ("live") falë bibliotekës së saj të integruar të tingujve, videove, imazheve, formave, animacioneve redaktues HTML etj. Mësuesit mund të ngarkojnë përmbajtjen e orës së mësimit e tyre, të bëjnë shënime dhe të shpërndajnë faqet e internetit nga një platformë e centralizuar.

**Vlerësimi:** OpenBoard është një mjet i shkëlqyeshëm për t'u përdorur në klasë nga mësuesit që të angazhohen me nxënësit e tyre. OpenBoard ofron një shumëllojshmëri mundësish për t'i bërë klasat më interaktive dhe për të personalizuar përmbajtjen sipas nevojës.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://openboard.ch/index.en.html>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Frëngjisht dhe Italisht



## ActivePresenter

## ActivePresenter

**Funksionet kryesore:** Regjistrimi/redaktimi/shpërndarja e videove

**Përshkrimi:** ActivePresenter është një regjistruer ekrani, redaktues videosh dhe program për të mësuar në mënyrë elektronike (e-Learning -Electronic Learning); të gjitha në një. Ky mjet lejon krijimin e videove shpjeguese, si dhe përmbajtje e-Learning në HTML. Për më tepër, ActivePresenter krijon mundësi për importimin e një prezantimi në PowerPoint dhe redaktimin e tij. Mësuesve ju jepet mundësia të përfshijnë lloje të ndryshme aktiviteteve në materialet e tyre të mësimit elektronik, të tilla si kuize, pyetje me plotësim të vendeve bosh.

**Vlerësimi:** ActivePresenter është një mjet ndërveprues që u jep mundësinë mësuesve të krijojnë përmbajtjen e mësimit në internet nga e para. Ky mjet kërkon një mësues me njohuri të mira teknologjike dhe të ketë të shkarkuar ActivePresenter në kompjuter. Ky program ka një gamë të gjerë funksionesh që e bëjnë gjithçka plotësisht të personalizueshme, duke e bërë krijimin e videove shpjeguese ose përmbajtjeve të e-Learning fleksibël dhe individuale. Versioni falas përfshin të gjitha veçoritë dhe nuk ka një kufi kohor, megjithatë, eksportimi i videove shpjeguese në forma të tjera do të shoqërohet me një "stampë" (simbol me logon/emrin e mjetit).



**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://atomisystems.com/activepresenter/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale, prezantim (p.sh. leksione, tregime)

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Frëngjisht dhe Italisht



## Timelinely

### Timelinely

**Funksionet kryesore:** Krijues i sekuencave në një video

**Përshkrimi:** Timelinely është një faqe interneti që u lejon mësuesve dhe nxënësve të shtojnë çdo URL të Youtube-it dhe t'i modifikojnë ato duke shtuar komente ose përmbajtje mediatike si linqe, vendndodhje në GoogleMap, video ose imazhe. Në këtë mënyrë, mësuesit dhe nxënësit mund të nxjerrin në pah pjesë interesante dhe të rëndësishme të videos ose të krijojnë aktivitete interaktive.

**Vlerësimi:** Timelinely është një mjet intuitiv dhe i lehtë për t'u përdorur. Është shumë i dobishëm për të theksuar momente ose fraza të rëndësishme nga videot në Youtube dhe mund të përdoret për të tërhequr vëmendjen e nxënësve në pjesë të veçanta të videove.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.timeline.ly/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht

**Funksionet kryesore:** Mësim në gjuhë të huaj

**Përshkrimi:** ILOBify është një aplikacion online falas i krijuar nga mësuesit për të ndihmuar nxënësit të përmirësojnë aftësitë e tyre në Frëngjisht dhe Anglisht. Ky mjet ofron burime të ndryshme si kurse ose aplikacione për të praktikuar dy gjuhët, si dhe rekomandime për të lexuar dhe shkruar. Përveç kësaj, ofron mundësinë e një sesioni bisede me një folës vendas për të përmirësuar aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit. Është plotësisht falas dhe nxënësit duhet vetëm të regjistrohen në mënyrë që të kenë akses në të gjitha burimet.

**Vlerësimi:** Mjet i shkëlqyeshëm për të përmirësuar aftësitë gjuhësore në Frëngjisht dhe Anglisht. Ai ofron shumë mundësi të ndryshme për praktikimin e gjuhëve dhe mund të përdoret si në telefon ashtu edhe në kompjuter, pasi e vetmja kërkesë është të keni link-un e faqes së internetit dhe të krijoni një llogari për të hyrë në këtë faqe.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://ilobify.glideapp.io/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht, Frëngjisht



## Sutori

### Funksionet kryesore: Planifikim lëndor

**Përshkrimi:** Sutori është një platformë online e cila u mundëson mësuesve të krijojnë mësimet digjitale interaktive për nxënësit e tyre. Mësuesit mund të zgjedhin midis përdorimit të një modeli (shablloni) dhe modifikimit të tij ose krijimit të prezantimit nga fillimi. Versioni falas i Sutorit lejon personalizimin e orëve të mësimit duke mundësuar përdorimin e të gjitha llojeve të burimeve, qofshin ato tekste, imazhe, audio ose video. Këto burime shfaqen në platformë përgjatë një afati kohor, në mënyrë që nxënësit të shohin rendin në të cilin mund t'i përdorin ato. Sutori gjithashtu lejon mësuesit të ftojnë nxënësit për të krijuar projekte të ndryshme dhe njëkohësisht të mbikëqyrni punën e tyre. Këtu janë disa ide se si mund të përdoret kjo platformë me nxënësit e gjuhës së huaj.

**Vlerësimi:** Sutori u jep mësuesve mundësinë për të krijuar mësimet argëtuese dhe interaktive për nxënësit e tyre. Disa nga modelet/shabllonet që ofron janë të klasifikuara sipas lëndëve, duke e bërë kështu përgatitjen e orëve mësimore më të shpejtë dhe më të lehtë.

**Çmimi:** Nëse regjistrohesh është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.sutori.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht





## Flippity

**Funksionet kryesore:** Aplikacion i lojërave me fletë treguese (Flashcard)

**Përshkrimi:** Flippity është një mjet falas në internet që lejon krijimin e lojërave interaktive me fletë treguese, bazuar në Google Spreadsheets. Shabllonet jepen të gatshme, kështu që mësuesit duhet vetëm të hyjnë në faqen e internetit dhe të zgjedhin tabelën (spreadsheet) që ju pëlqen. Çdo tabelë shoqërohet me një sërë udhëzimesh që shpjegojnë se si mund të kthehet një dokument në material të dobishëm pedagogjik për orën e mësimit. Mësuesit gjithashtu kanë mundësinë të krijojnë materiale direkt në shfletues (browser) nëse nuk dëshirojnë të përdorin llogarinë e tyre në Google, por në këtë rast mundësitë janë më të kufizuara.

**Vlerësimi:** Flippity është një mjet shumë i drejtpërdrejtë për t'i bërë orët e mësimit më interaktive dhe argëtuese. Shumë e lehtë për t'u përdorur dhe me një gamë të gjerë aktiviteteve për të zgjedhur.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.flippity.net/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht



## UsingEnglish

**Funksionet kryesore:** Mësimi në gjuhë e huaj

**Përshkrimi:** UsingEnglish.com është një faqe interneti e specializuar për mësimin e gjuhës angleze. Ofron një numër të madh fletësh pune, ushtrimesh dhe kuizesh për praktikimin e aftësive të ndryshme si fjalori, gramatika, të shkruarit dhe të lexuarit. Ushtrimet ndahen sipas aftësive ose temave.

**Vlerësimi:** Faqe interneti e lehtë për t'u përdorur për mësuesit dhe nxënësit e gjuhës angleze. Ajo ofron jo vetëm ushtrime të ndryshme, por edhe shpjegime për kategori të ndryshme gramatikore.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.usingenglish.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të lexuarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht

# Crossword Labs

## Crosswords Lab

**Funksionet kryesore:** Krijues fjalëkryqesh

**Përshkrimi:** Crossword Labs është një mjet digjital falas për të ndërtuar, printuar, shpërndarë dhe zgjidhur fjalëkryqe. Mësuesi duhet vetëm të zgjedhë një titull, si dhe fjalët që dëshiron të përfshijë në të dhe ky aplikacion do të bëjë të gjithë punën për për mësuesin. Fjalëkryqet mund të krijohen në çdo gjuhë. Mësuesi mund të gjejë gjithashtu një fjalëkryq të gatshëm për shumë tema të ndryshme.

**Vlerësimi:** Crossword Labs është një mjet i thjeshtë dhe efektiv për të krijuar të gjitha llojet e fjalëkryqeve. I shkëlqyeshëm për nxënësit për të praktikuar fjalorin ose gramatikën.

**Çmimi:** Falas (Plani Premium është i disponueshëm)

**Website (Faqja e internetit):** <https://crosswordlabs.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht

Over one million crossword puzzles made!




**Sample Crosswords**

- [The Planets](#)
- [Weather](#)
- [Animals](#)

Crossword Labs

Make a Crossword Find a Crossword About Login/Sign Up

Frozen Characters



Edit Regenerate Save

## Testmoz

### Testmoz

**Funksionet kryesore:** Krijues kuizesh

**Përshkrimi:** Testmoz është një krijues kuizesh në internet i cili mund të përdoret për të bërë teste plotësisht të personalizuar për nxënësit. Mësuesi mund të zgjedhë midis llojeve të ndryshme të pyetjeve, si p.sh. me shumë zgjedhje, e vërtetë/e gabuar ose plotësoni vendet bosh dhe pastaj importon pyetje nga skedarët dhe testet e tjera. Pasi të ketë përfunduar testi, mësuesi mund të shikojë të gjitha rezultatet së bashku ose të nënvizojë rezultatet e një nxënësi dhe mund të japë përgjigje për gjithë klasën ose për secilin nxënës në mënyrë individuale.

**Vlerësimi:** Testmoz është një aplikacion shumë i thjeshtë për krijimin e testeve duke përdorur lloje të ndryshme pyetjesh. Mund të ngarkohen video, imazhe dhe mundësi të tjera. E vetmja pengesë është se versioni falas lejon të krijohen vetëm deri në 50 pyetje për test dhe testi mund të bëhet për 100 përdorues maksimumi.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://testmoz.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht

## Testmoz

## Quizalize

**Funksionet kryesore:** Krijues kuizesh

**Përshkrimi:** Quizalize është një faqe interneti për të krijuar kuize. Mësuesit mund të krijojnë kuize dhe t'i ndajnë ato me mësues të tjerë. Ata gjithashtu mund të përdorin kuize të bëra nga mësues të tjerë në faqen e internetit. Mësuesit mund të krijojnë lloje të ndryshme kuizesh, si ushtrime me zgjedhje të shumëfishta, pyetje me shkronja të ngatërruara, pyetje të vërteta ose të gabuara. Më pas nxënësit mund të hyjnë në kuiz me një kod dhe të shohin pyetjet në pajisjet e tyre. Mësuesit janë në gjendje të shohin se si çdo nxënës po përparon dhe ata gjithashtu mund të shfaqin përparimin për të gjithë klasën. Pas kuizit, mësuesit mund të shohin se cilët nxënës kanë dalë mirë dhe cilët kanë nevojë për ndihmë. Nxënësit mund të shohin gjithashtu rezultatet e tyre, sa kohë u duhej për secilën pyetje si dhe një listë me pyetje, përgjigje të sakta dhe përgjigjet e tyre. Quizalize mund të lidhet me Google Classroom.

**Vlerësimi:** Quizalize është një mjet i shkëlqyeshëm për t'i bërë orët e mësimit më interaktive dhe argëtuese për nxënësit. Kjo i lejon mësuesit të kenë një pasqyrë të përparimit të nxënësve të tyre dhe të shohin se cilët nxënës kanë nevojë për më shumë ndihmë. Prandaj, Quizalize mund të përdoret gjithashtu për vlerësimin e nxënësve.

**Çmimi:** Nëse bën regjistrim është falas (*Plani premium është i disponueshëm*)

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.quizalize.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht


**Quizalize** [Book a demo!](#) [Pricing](#) [Blog](#) [Help](#) [Teacher login](#) [Students enter code](#) [Try Quizalize for FREE](#)

# TURN ANY QUIZ INTO AN EPIC CLASSROOM GAME


**Teachers** get started, it's free!  
**Students** join your class  
**Watch** to learn more

## Step 2 Make it... EPIC!

**Show a team game on your big screen**  
When students answer the quiz correctly their team scores on the big screen game!



**Brand new games launching now!**  
[No setup - find out more](#)





## TeacherMade

**Funksionet kryesore:** Rregullues për ushtrime me pyetje/përgjigje, Krijues kuizesh

**Përshkrimi:** TeacherMade është një mjet online që lejon mësuesit të transformojnë pothuajse çdo burim në një aktivitet digjital interaktiv. Mësuesi duhet të ngarkojë skedarët që dëshiron të përdorë si sfond dhe të fillojë të shtojë pyetje në to. Ekzistojnë 13 lloje të ndryshme pyetjesh për të zgjedhur, duke përfshirë zgjedhje të shumëfishta, përgjigje të shkurtra, të vërteta/gabuara. Për më tepër, TeacherMade ka edhe një funksion shumë të dobishëm që kujdeset për vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve.

**Vlerësimi:** TeacherMade është një mjet shumë i dobishëm për t'i bërë materialet e orës së mësimit më interaktive për nxënësit. Ai gjithashtu përshpejton procesin e përgatitjes së mësimeve dhe vlerësimin të detyrave të shtëpisë ose provimeve. Versioni falas ka disa kufizime në lidhje me materialin që mund të shtohet në fletët e punës.

**Çmimi:** Nëse bën regjistrim është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://teachermade.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht



## Liveworksheets

**Funksionet kryesore:** Rregullues për ushtrime me pyetje/përgjigje

**Përshkrimi:** Liveworksheets është një mjet që lejon mësuesit të krijojnë fletë pune ndërvepruese për nxënësit e tyre. Mësuesit ngarkojnë fletë pune tradicionale në PDF ose si dokumente Word dhe më pas mund t'i transformojnë ato në ushtrime ndërvepruese duke përdorur formate të ndryshme si p.sh. me zgjedhje të shumëfishta, tërhiqni dhe lëshoni, bashkoni shigjetat, të cilat mund të përfshijnë audio ose video nëse është e nevojshme. Gjithashtu, është e mundur të krijohen ushtrime për aftësinë e të folurit ku nxënësit duhet të regjistrojnë veten duke përdorur mikrofonin e aplikacionit. Mund të aksesohen gjithashtu një sërë fletë pune të krijuara tashmë nga përdorues të tjerë.

**Vlerësimi:** Liveworksheets është një mjet i dobishëm për krijimin e ushtrimeve ndërvepruese për nxënësit. Është e lehtë për t'u përdorur nga mësuesit dhe mund ta bëjë mësimin më argëtues dhe të këndshëm. Megjithatë, duke pasur parasysh mundësitë e ndryshme të disponueshme, mësuesit duhet të zgjedhin me kujdes formatin më të përshtatshëm të ushtrimeve që kërkohet për çdo aktivitet mësimor.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://teachermade.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të lexuarit, Të folurit, Të shkruarit, Fjalori

**Gjuha:** Anglisht





## Educandy

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Educandy është një faqe interneti dhe një aplikacion që ndihmon mësuesit të krijojnë aktivitete mësimore të shkurtra dhe ndërvepruese. Mësuesit vendosin fjalë, pyetje me përgjigje dhe faqja e internetit e konverton këtë informacion në lojëra interaktive argëtuese, si p.sh. fjalëkryq, kuize dhe lojëra të tjera, të cilat mund të luhen me të gjithë klasën ose individualisht. Kur mësuesi krijon një aktivitet, krijohet një kod unik, i cili më pas mund të ndahet me nxënësit në mënyrë që ata të luajnë lojërat në pajisjet e tyre. Aktivitetet gjithashtu mund të futen në faqet e internetit.

**Vlerësimi:** Educandy është një mjet i dobishëm për krijimin e lojërave tërheqëse, argëtuese, ndërvepruese që nxënësit të praktikojnë fjalorin. Është e lehtë për t'u përdorur dhe nuk kërkon shumë kohë.

**Çmimi:** Nëse bën regjistrim është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.educandy.com>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Fjalor

**Gjuha:** Anglisht



## ESL Video

**Funksionet kryesore:** Krijues kuizesh, regjistrim në video, editim, shpërndarje

**Përshkrimi:** ESL Video është një faqe interneti që ofron aktivitete gramatikore dhe dëgjimore si dhe materiale mësimore për nxënësit dhe mësuesit e gjuhës angleze. Gjithashtu i lejon mësuesit të krijojnë materialet e tyre mësimore si kuize që bazohen në videot e YouTube. ESL Video lejon mësuesit të ndjekin rezultatet e nxënësve të tyre. Të gjitha videot janë të kategorizuara sipas niveleve, duke filluar nga niveli gjuhësor fillestar Alderi tek niveli më i avancuar C1. Ju mund të shihni një shembull me një video dhe një kuiz këtu: <https://www.eslvideo.com/quiz.php?id=37534>

**Vlerësimi:** Duke përdorur video të botës reale, si lajme, biseda edukative dhe frymëzuese, video muzikore ose klipe të shkurtra nga filma dhe seriale, ESL Video i ndihmon nxënësit të punojnë në aftësitë e tyre të dëgjimit. Nëpërmjet kuizeve, nxënësit mund të kontrollojnë gjithashtu të kuptuarit e tyre dhe të punojnë në aftësitë e tyre gramatikore. Mësuesit mund të kenë akses në materiale të tjera të shpërndara nga mësues të tjerë dhe të krijojnë një kod klase për videot e tyre në mënyrë që ata të mund të shohin rezultatet e nxënësve të tyre. Mësuesit gjithashtu mund të krijojnë faqen e tyre të klasës në mënyrë që të mund të kenë të gjitha videot e në një vend. Për më shumë informacion, shihni udhëzuesin e përdoruesve: [https://www.eslvideo.com/users\\_guide.php](https://www.eslvideo.com/users_guide.php)

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://eslvideo.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit

**Gjuha:** Anglisht



QUIZZES CREATE TEACHING MATERIAL ITCE

together against the war in Ukraine!

### QUIZ SERIES



**Beginning English Grammar - Using Be**  
Beginning



**Easy English**  
Beginning



**Jumanji 2**  
Intermediate



#### LEVELS

- > (A1) Beginning
- > (A2) Low Intermediate
- > (B1) Intermediate
- > (B2) High Intermediate
- > (C1) Advanced

#### CATEGORIES

- > Grammar
- > Animals



**Songs**  
Beginning - High Intermediate



**Friends**  
Intermediate - High Intermediate



**Ted Talks**  
High Intermediate - Advanced

### LEVELS



**Beginning (A1)**



**Low Intermediate (A2)**



**Intermediate**



**High Intermediate**



**Advanced**

- > Health & Beauty
- > Food & Cooking
- > Tech & Innovation
- > Lifestyle & Culture
- > Travel & Adventure
- > Fun & Entertainment
- > Business & Corporate
- > Nature & Science
- > Christmas - Hanukkah
- > Halloween



## Timeline JS

**Funksionet kryesore:** Krijuesi Timeline

**Përshkrimi:** Timeline JS është një mjet që ndihmon për të treguar një ngjarje ose histori duke krijuar afate kohore që janë vizualisht të pasura dhe ndërvepruese. Timeline JS është shumë e lehtë në përdorim dhe lejon që të shtohet përmbajtje ndërvepruese si për shembull linqe, imazhe, video, Google Maps, Tweets ose sfonde. Timeline JS është e lidhur me Google Drive në mënyrë që të gjitha të dhënat mund të modifikohen në Google spreadsheet. Mësuesit gjithashtu mund të ndryshojnë gjuhën e prezantimit.

**Vlerësimi:** Timeline JS është një mjet i lehtë për t'u përdorur në bërjen e afateve kohore ndërvepruese dhe prezantimeve.

**Çmimi:** Nëse bën regjistrim është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://timeline.knightlab.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale. Prezantim (*psh.mësimdhënie, rrëfim*)

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht



## Anchor

**Funksionet kryesore:** Regjistrim audio/ redaktim/ shpërndarje

**Përshkrimi:** Anchor është një mjet tërësisht falas që lejon krijimin e podcast-e audio nga kompjuteri ose nga telefoni dhe ngarkimin e regjistrimeve audio të bëra me programe të tjera. Kur ju jeni gati të publikoni podcast-in tuaj, me një të shtypur butoni ai do të shpërndahet në platformat kryesore të podcast-eve, sikurse janë podcast-et Apple, podcast-et Google dhe Spotify. Përdoruesit që ndodhen në Shtetet e Bashkuara mund të fitojnë para duke zgjedhur të përfshijnë reklama në podcastet e tyre.

**Vlerësimi:** Një përparësi e madhe e Anchor është të qenët plotësisht falas. Nuk ka periudhë prove pas së cilës nxënësit duhet të paguajnë për të vazhduar në përdorimin e mjetit. Gjithashtu nuk ka version premium, që do të thotë se të gjithë nxënësit kanë akses në të gjitha funksionet. Për shembull, nxënësit mund të bëjnë podcastet të duken më profesionale duke shtuar muzikë në sfond ose efekte zanore, nga Libraria. Mundësia "Record With Friends" i lejon ata të krijojnë podcastet deri në pesë shokë në distancë në telefonat e tyre, i cili do të ishte një mënyrë shumë e mirë për aktivitete të folurit në grup. Për podcaste me më pak se një minutë, nxënësit mund të zgjedhin të kenë regjistrimin të përshtatur në një video të transkriptuar, gjë e cila do të ishte shumë e dobishme për nxënësit me nivel më të ulët gjuhësor. Një mangësi e vogël është që, pavarësisht se Anchor është një mjet edukimi, kjo është në njëfarë mënyre e limituar. Nëse nxënësit janë të interesuar në bërjen e një redaktimi më të avancuar, ata mund të konsiderojnë përdorimin e softwareve audio-edituese (psh. Audacity), dhe pastaj të ngarkojnë dosjen përsëri tek Anchor për ta publikuar.


**Çmimi:** Nëse bën regjistrim është falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://anchor.fm/>


**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale. Prezantim (psh. mësimdhënie, rrëfim)

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të folurit, Fjalori

**Gjuha:** Anglisht (Faqet ndihmëse të gatshme në Anglisht, Gjermanisht, Indonezisht, Portugalisht dhe Spanjisht)



The screenshot shows the Anchor website homepage. At the top left is the Anchor logo with "by Spotify" underneath. The navigation menu includes "Features", "Switch to Anchor", "Ads by Anchor", and "Blog". On the right, there are links for "Sign in", "Sign up", and "EN". The main heading reads "Say it all with Anchor". Below it, the text says "Spotify's free podcasting platform—the easiest way to create, distribute, and monetize your show." A yellow "Get started" button is prominent. Below the button, it says "Already have a podcast? [Switch to Anchor](#)". On the right side, there is a video thumbnail of a man wearing headphones and speaking into a microphone. At the bottom left, there is a smaller video thumbnail of a woman at a computer.



The screenshot shows the Anchor blog page. The heading is "Podcasting tips, creator stories, and Anchor news". Below it, the text says "Our blog, Word of Mouth, has everything you need to get started or take your show to the next level." A yellow "See the latest" button is visible. The page features several video thumbnails: a woman in a car, a group of people with colorful avatars, a woman speaking, and a person at a desk. There is also a circular graphic element with a play button icon.

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Faqe interneti e të mësuarit të gjuhës nëpërmjet lojës e cila ofron materiale ndërvepruese për të mësuar rreth 80 gjuhë, duke përfshirë shumë minoritete dhe gjuhë të rrezikuara (në zhdukje). Materialet përmbajnë ushtrime për praktikimin dhe mësimin e gramatikës, fjalorit, gërmëzimit, fjalive, teksteve dhe alfabeteve. Listat e fjalëve janë të shoqëruara me audio për të praktikuar aftësitë e shqiptimit dhe të dëgjuarit. Lojrat dhe ushtrimet janë të lehta për t'u përdorur nga fëmijët e vegjël. Faqja e internetit gjithashtu përmban informacion rreth kulturës dhe gjuhës, linqe të burimeve të tjera të dobishme dhe truke në mësimin e gjuhës.

**Vlerësimi:** Burim i dobishëm për të mësuar fjalorin bazë. Është veçanërisht i përshtatshëm për nxënësit më të rinj për shkak të tipareve ndërvepruese. Përmban lojëra për të mësuar gjuhët e minoriteteve dhe gjuhë të rrezikuara (në zhdukje) sikurse Cook Island Maori, Horami, Saami, Nuiean dhe Karelian.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.digitaldialects.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të dëgjuarit, Të lexuarit, Fjalori

**Gjuha:** Anglisht



## Romanica

**Funksionet kryesore:** Aplikacion loje

**Përshkrimi:** Romanica është një lojë e prodhuar nga Ministria e Kulturës Franceze e cila i çon lojtarët në botë të ndryshme ku ata duhet të njohin kuptimin e fjalëve dhe gjuhën së cilës ato i përkasin. Fjalët janë të gjitha nga gjuha Romaneske (Frëngjisht, Rumanisht, Italisht, Spanjisht, Portugalisht, Katalanase, Okitane dhe Korsiane) dhe ndërkohë që nxënësi përparon, gjatë lojës shfaqen dhe më shumë fjalë, informacion kulturor dhe jepen stema.

**Vlerësimi:** Është një mënyrë krijuese për nxënësit që të praktikohen dhe të mësojnë fjalor të ri në gjuhët rumaneske. Mund të jetë pak e vështirë pa njohuri fillestare të gjuhës, por është akoma e menaxhueshme.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://shorturl.at/bFKP8>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të lexuarit, Fjalori

**Gjuha:** Frëngjisht, Rumanisht





## Pixton

**Funksionet kryesore:** Krijim tregimesh komikë

**Përshkrimi:** Pixton përdoret për të krijuar tregime të thjeshta komike. Nxënësit zgjedhin nga një shumëllojshmëri shabllonesh, romanesh me figura komike, tabelash me tregime. Librat me figura janë të personalizuar me një numër të madh personazhesh, shabllonesh (modelesh) dhe sfondesh të disponueshme. Ata gjithashtu mund të shtojnë flluska me informacion (speech bubbles), ndryshojnë mimikat e personazhit, pozat, veshjet, dhe sfondet.

**Vlerësimi:** Është një mënyrë krijuese për nxënësit që të praktikohen dhe të mësojnë fjalor të ri në gjuhët rumaneske. Mund të jetë pak e vështirë pa njohuri fillestare të gjuhës, por është akoma e menaxhueshme. Faqja është e thjeshtë për t'u përdorur dhe e përshtatshme për të gjitha moshat. Në momentin që nxënësit kanë krijuar një libër me figura, ata mund ta ruajnë atë për më vonë, ose ta shpërndajnë online. Pixton ia vlen të përdoret për aktivitete të shkruarit krijues. Krijimi i fotove do të marrë kohë, por do të jetë gjithashtu motivues. Përdorimi i këtij formati nga nxënësit mund të jetë i thjeshtë ose i ndërlikuar. Vendosja e personazhit (avatar) është e mirë për një fjalor të thjeshtë përshkrimi, i disponueshëm në Anglisht, Spanjisht dhe Frëngjisht. Mësuesit mund të gjejnë sugjerime për aktivitete në klasë.


**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.pixton.com/>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift; Punë individuale

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të shkruarit

**Gjuha:** Anglisht, Spanjisht, Frëngjisht



FRANÇAIS ESPAÑOL

**Pixton**

[Educators](#) [Students](#) [Parents](#) [Business](#)


[SIGN UP](#) [LOG IN](#)

## Give your students superpowers!

Turn them into comic creators. Pixton cures classroom boredom and empowers every student, by unleashing their artistic and writing potential.

[TAKE A TOUR](#) [TRY THE COMIC BUILDER >](#)

?



$5 \times 12 = ?$

## BANG! for your buckaroos

Because Pixton is an incredibly powerful writing tool, you will use it again and again. Language arts? POW! Math and science? KABLOOEY! Make your dollars stretch like Elasti-girl on a summer's day.

[CREATE AN ACCOUNT](#)



## Toony Tool

**Funksionet kryesore:** Rrëfim

**Përshkrimi:** Toony Tool është një krijues memesh, filmash vizatimorë, librash me figura online. Nxënësit mund të krijojnë filmat e tyre vizatimorë, librat me figura dhe meme duke përdorur imazhe, personazhe të mundësuar në faqen e internetit ose mund të përdorin imazhet e tyre. Me të mbaruar, nxënësit kanë mundësinë ta shpërndajnë online ose ta shkarkojnë dhe ta printojnë. Është shumë e lehtë për ta përdorur.

**Vlerësimi:** Toony Tool është një burim fantastik për të bërë filma vizatimorë, libra me figura dhe meme. Është më e përshtatshme për nxënësit e klasave të ulëta, pasi personazhet janë pak fëmijërorë. Nxënësit nuk mund ta ruajnë progresin dhe të kthehen më vonë. Toony Tool është një ndihmë e dobishme për të praktikuar të shkruarin krijues.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.toonytool.com>

**Lloji i ndërveprimit:** Punë në grup ose në çift, punë individuale,.

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të lexuarit, Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht, Gjermanisht

**Funksionet kryesore:** Krijues i reve me fjalë

**Përshkrimi:** AnswerGarden është një mjet i thjeshtë për t'u përdorur dhe i përshtatshëm për stuhi mendimesh (brainstorming) ose për të grumbulluar feedback në klasë. Mësuesi, pasi shkruan një pyetje në AnswerGarden, mundëson nxënësit me një link për të hyrë dhe pret që ata të shkruajnë përgjigjet e tyre, gjë e cila më pas do të formojë figurën e një reje fjalësh.

**Vlerësimi:** Mjet i thjeshtë për t'u përdorur, i mirë për të grumbulluar feedback dhe zotërimin e njohurive të një teme të caktuar. Ka rezultat më të mirë kur punohet me pyetje të thjeshta me përgjigje njëfjalëshe pasi ka një limit karakteresh.

**Çmimi:** Falas

**Website (Faqja e internetit):** <https://www.answergarden.ch/>

**Lloji i ndërveprimit:** PPunë në grup ose në çift.

**Aftësitë gjuhësore që zhvillohen:** Të lexuarit, Të shkruarit, Fjalori, Gramatika

**Gjuha:** Anglisht

# Shembuj praktikë për përdorimin e mjeteve të teknologjisë në lëndën e gjuhës së huaj



## Padlet.com

Padlet, një nga instrumentet online më të thjeshta për t'u kuptuar dhe përdorur, është i organizuar në formën e një dërrase online fleksibël, plot ngjyra dhe me një hapësirë pa fund. Ai mund të përdoret nga mësuesit dhe nxënësit për të postuar shënimet dhe punët e tyre në një faqe të përbashkët. Pasi mësuesi krijon llogarinë e tij në versionin pa pagesë, mund të hyjë në nëntë dërrasa (nëse dëshiron të ketë më shumë dërrasa, mund të abonohet me pagesë ose të fshijë dërrasat e përdorura më parë). Padleti ka shumë opsione për sfondin e dërrasës dhe udhëzime se si mund të prezantohet informacioni i cili mund të postohet si tekst, video ose imazh. Mësuesi, si një moderator, mund të kontrollojë se cili nxënës e bën postimin dhe, nëse postimet janë publike ose vetëm për nxënësit e klasës. Nëse dëshiron, mësuesi mund t'i lejojë nxënësit të komentojnë dhe të shtojnë vlerësimin e tyre në postime. Padlet-i mund të punohet shumë thjesht nga smartfoni.




Figura 1- Picture credit: Padlet

## Shembuj:

**1.** Gjatë orës së mësimit online ose mësimit të drejtpërdrejtë në klasë, mësuesi mund të bëjë pyetje për të kontrolluar nëse nxënësit e kanë kuptuar materialin e dhënë dhe ju kërkon nxënësve të shkruajnë përgjigjet e tyre në Padlet. Nëpërmjet kësaj veprimtarie nxënësit forcojnë aftësinë për të shkruar dhe gjithashtu e lejon mësuesin të shohë se a kanë marrë pjesë të gjithë nxënësit.

**2.** Gjatë një ore mësimi të drejtpërdrejtë në klasë apo online, në dhomat e chat-it në Zoom ose Skype, mund të përdoret Padlet për të ndihmuar nxënësit të kontrollojnë punën e njëri- tjetrit në çift ose në grupe të vogla. P.sh, nëse nxënësit po punojnë për një projekt mbi të ushqyerin e shëndetshëm, një grup nxënësish caktohen të hulumtojnë dhe të gjejnë informacione të cilat mund t'i postojnë në Padlet. Grupet e tjera mund të shqyrtojnë nëse këto informacione janë të besueshme apo jo, para se të përgatisin draftin e projektit.

**3.** Padlet-i mund të përdoret edhe kur nxënësit bëjnë prezantime. Gjatë prezantimit online mësuesi ose nxënësit mund të bëjnë pyetje për t'u siguruar që të gjithë po ndjekin njëri tjetrin dhe secili përgjigjet në Padlet. Për të siguruar një pjesëmarrje sa më aktive, mësuesi vlerëson me pikë nxënësit që bëjnë pyetje dhe shkruajnë në Padlet.

**4.** Fig. 2 tregon se si një mësues e ka përdorur Padlet për një projekt ku nxënësit postojnë fotot që ata kanë marrë gjatë një ekskursioni të zhvilluar me klasën. Pas postimit të fotove, nxënësit votojnë për foton më të bukur duke dhënë argumente se përse zgjedhin atë foto. Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë jo vetëm aftësinë e të folurit, por edhe aftësinë e të menduarit kritik






Figura 2- Picture credit. Padlet

5. Fig. 3 tregon një detyrë që nxënësit e një klase kanë zhvilluar në orën e gjuhës angleze me temën "About me". Mësuesi ka si qëllim që nxënësit të praktikojnë kohën e tashme dhe të shkuar të foljeve duke folur për veten e tyre, dëshirat etj.



Figura 3- Picture credit: Padlet

6. Pamjet e mëposhtme janë faqet e një Padlet-i i cili tregon se si mësues të gjuhëve të huaja nga vende të ndryshme të Europës kanë bashkëpunuar për realizimin e një projekti në kuadër të 26 Shtatorit, Ditës Europiane të Gjuhëve. Nxënësit kanë shkruar përshëndetje në gjuhën e tyre dhe kanë prezantuar shkollën, qytetin dhe shtetin e tyre. Në këtë projekt kanë marrë pjesë edhe mësues dhe nxënës nga Shqipëria.





## Flip.com

Flip është një platformë pa pagesë për të krijuar video dhe përdoret në mënyra të ndryshme. Kjo platformë mund të ngarkohet në telefon, kompjuter dhe laptop ose mësuesit dhe nxënësit mund të futen direkt online nëpërmjet llogarisë që ata kanë në Microsoft ose Google. Kërkesa e vetme e përdorimit të kësaj platforme është që pajisjet të kenë një kamerë. Mësuesi ose nxënësit si përdorues të kësaj platforme mund të vendosin që videot, të cilat zgjasin nga 30 sekonda deri në pesë minuta, t'i ketë private ose publike.

Në përdorimin bazë, Flip është një instrument video që lejon mësuesin të postojë në "Topics" (temat), të cilat janë kryesisht video të shoqëruara me tekst. Mësuesi i ndan këto video me nxënësit dhe i inkurajon ata të përgjigjen. Përgjigjet realizohen duke përdorur kamerën e kësaj platforme dhe postohen tek "Topics". Videot mund të rregjistrohen disa herë para se të ngrakohen dhe mund të kenë emoji, tekst, stickera, vizatime etj. Kjo ndihmon nxënësit të jenë krijuar dhe të shprehur lirshëm.

Flip mund të integrohet me Google Classroom, Microsoft Teams dhe u jep mundësinë mësuesve ta përdorin në organizimin e orës së mësimit online. "Grid" është një term që përdoret në Flip për të përshkruar një grup nxënësish.




Figura 4- Picture credit: Flip



### **Shembuj:**

- Mësuesi mund ta përdorë Flipgrid në fillim të vitit shkollor kur u kërkon nxënësve të prezantojnë veten e tyre dhe se çfarë presin ata të mësojnë gjatë atij viti shkollor. Nxënësit përgatisin video dhe i prezantojnë në Flipgrid.
- Flipgrid mund të përdoret për të praktikuar shqiptimin ose të folurin në publik dhe mësuesi u kërkon nxënësve të krijojnë video ku ata recitojnë ose prezantojnë punimet e tyre.
- Nxënësit e përdorin Flipgrid kur prezantojnë punët e tyre të projektit dhe mësuesi kërkon që nxënësit e tjerë të bëjnë një vlerësim me gojë për punën e secilit që ka prezantuar, bazuar në një rubrikë vlerësimi të cilën mësuesi e ka përgatitur më parë.
- Mësuesi mund të krijojë një “grid” (grup) për punët e portofolit të nxënësve. Mësuesi krijon një “Topic” për secilin nxënës dhe nxënësit postojnë videot e tyre ku ata shpjegojnë detyrat e realizuara. Mësuesi mund ta ndajë këtë video me prindërit e nxënësve në mënyrë që ata të shohin punimet e fëmijëve të tyre gjatë vitit.
- Flipgrid mund të përdoret nga mësuesi për të ndihmuar nxënësit që kanë munguar në një orë mësimi. Mësuesi krijon një “Topic” për detyrat që janë bërë në klasë, ku një nga nxënësit poston një video në të cilën shpjegon detyrat e zhvilluara. Në këtë mënyrë, nxënësit që kanë munguar atë orë mësimi, marrin informacionin e asaj ore mësimi.
- Një mënyrë shumë e mirë për të përdorur Flipgrid në orën e mësimi është organizimi i një takimi me ekspertë të një fushe të caktuar i cili është folës vendas apo i huaj. Nxënësit krijojnë videot e tyre me pyetjet që dëshirojnë t'i bëjnë dhe eksperti, pasi ka parë dhe dëgjuar këto video, poston përgjigjet e tij. Nxënësit në këtë mënyrë zhvillojnë aftësitë e tyre të folurit dhe të dëgjuarit si dhe rrisin njohuritë në fusha të caktuara.



## Kahoot!

Kahoot!, është një platformë lojrash për mësimnxënien që përdoret nga shumë profesionistë në fushën e arsimit dhe edukimit në botë. Kjo platformë është krijuar për të luajtur, krijuar, zbuluar dhe mësuar. Platforma mund të përdoret në çdo lëndë nga të gjithë mësuesit, për çdo moshë dhe në çdo pajisje duke e bërë procesin e të nxënit më argëtues dhe gjithëpërfshirës. Nxënësit nuk kanë nevojë të regjistrohen në një llogari. Mësuesi mund ta përdorë këtë platformë në klasë, për mësimin në distancë ose të kombinuar kur është duke përdorur Skype, Zoom ose Google classroom



Figura 5- Picture credit: Kahoot!

### Shembuj:

- Kahoot! mund të përdoret nga mësuesi për të kontrolluar nëse nxënësit e kanë kuptuar një pjesë leximi. Për këtë arsye, mësuesi harton disa pyetje me alternativa dhe ua dërgon nxënësve ku nxënësit mund t'u përgjigjen individualisht ose në grup.




Figura 6- Picture credit: Kahoot!

- Një mënyrë tjetër për të përdorur Kahoot është krijimi i kuizeve të ndryshme për koncepte të caktuara gramatikore, gjuhësore ose fjalorin e ri ku mësuesi merr informacion se sa materiali i shpjeguar është kuptuar nga nxënësit. Fig.6 tregon sesi mësuesi e ka përdorur Kahoot! për të testuar njohuritë e nxënësve në përdorimin e fjalëve të reja të mësimin.

- Për të organizuar një orë mësimi interesante, mësuesi mund ta përdorë Kahoot për të hartuar lloje të ndryshme ushtrimesh si: pyetje të vërteta ose të gabuara, pyetje me po ose jo, pyetje të hapura, sondazhe, stuhi mendimesh etj. Gjithashtu mësuesi mund të hartojë ushtrime ku nxënësi:
  - gjen cila fjalë është gramatikisht korrekte
  - identifikon fjalën që nuk i përket një grupi të caktuar fjalësh
  - gjen sinonimet ose antonimet e fjalëve të dhëna.
- Mësuesi mund të krijojë ushtrime dhe lojërat e veta me Kahoot! ose mund të marrë modele të gatshme në internet. Një burim shumë i mirë për mësuesit e gjuhës angleze për të përdorur lojëra dhe ushtrime të ndryshme me Kahoot! të organizuara sipas niveleve gjuhësore është faqja e Cambridge Assessment English, e cila ofron lojëra Kahoot! pa pagesë.

<https://www.cambridgeenglish.org/teaching-english/resources-for-teachers/kahoot/>



### Quizlet.com

Quizlet është një instrument të cilin mësuesit mund ta përdorin për të krijuar kuize për orën e mësimi në klasë ose në distancë. Quizlet ofron një gamë të gjerë materialesh duke filluar nga ato vizualet, lojërat me plotësime të vendeve bosh e shumë të tjera.

Në përdorimin e tij bazë, Quizlet është një databazë digjitale me kuize e cila ofron më shumë se 300 milion kartela treguese (flashcards) duke u dhënë mundësi mësuesve që të krijojnë paketën e tyre ose të editojnë setet egzistuese. Kartelat treguese janë të qarta për t'u kuptuar pasi ato kanë një pyetje, figurë, fjalë nga njëra anë dhe përgjigjen nga ana tjetër, të cilat mësuesi mund t'i përdorë gjatë orës së mësimi në ushtrime të ndryshme.

Quizlet është i ndarë në seksione sipas lëndëve të ndryshme, ku gjuhët e huaja janë pjesë e këtyre seksioneve. Quizlet brenda secilës lëndë ndahen nëseksionet: Flashcards (tabela treguese), Learn (mësoj), Spell (shqiptoj), Test (testoj), Match (kombinoj), Gravity (loja e gravitetit).

- Një nga mënyrat më të zakonshmet për të përdorur Quizlet është kur mësuesi shpjegon fjalët e reja të mësimit dhe kuptimet e tyre. Mësuesi përzgjedh fjalët kyçe të mësimit dhe krijon paketën me kartela treguese përkatëse. Pasi nxënësit i kanë mësuar këto fjalë, ata mund të praktikohen në Quizlet duke zhvilluar ushtrime të ndryshme. Shembulli në fig.7 tregon kartela treguese për një orë mësimi në gjuhën angleze me temën "Sports".




Figura 7- Picture credit: Quizlet

- Mësuesi mund ta përdori Quizlet edhe për të ndihmuar nxënësit të përmirësojnë shqiptimin e fjalëve në gjuhën e huaj. Gjatë orëve të mësimit, mësuesi mban shënime fjalësh që nxënësit shqiptojnë gabim dhe përgatit paketën me kartela treguese përkatëse në Quizlet dhe u kërkon atyre si detyrë shtëpie të dëgjojnë shqiptimin e këtyre fjalëve. Këtë veprimtari nxënësit e praktikojnë tek nënseksioni "Spell". Nxënësit i kërkohet jo vetëm ta shqiptojë fjalën, por edhe ta shkruajë atë duke përmirësuar aftësinë e të dëgjuarit, të folurit dhe të shkruarit njëkohësisht. Shembulli në fig.8 tregon se si një mësues ka përgatitur dy flashcards me dy fjalë në gjuhën angleze që shkruhen njësoj, por nxënësit e tij ngatërrohen në shqiptimin e tyre. Për këtë arsye, mësuesi ka përdorur jo vetëm fjalët, por edhe figurat për t'i ndihmuar nxënësit.



Figura 8- Picture credit: Quizlet



- Mësuesi mund të përdorë nënseksionin “Test”, “Match”, “Write” për të krijuar ushtrime të llojeve të ndryshme si: ushtrime me alternativa, e vërtetë e gabuar, më kombinime për të testuar se sa mirë nxënësit i kanë kuptuar fjalët e reja të një pjese mësimi. Për t’i bërë ushtrimet sa më tërheqëse, mësuesi, përveç fjalëve dhe shpjegimeve të tyre, vendos edhe figura të ndryshme. Në fig.9 tregohet se si një mësues ka përgatitur një ushtrim me kombinime për të kontrolluar se sa mirë nxënësit i kanë mësuar fjalët kyçe të kapitullit me temën “Clothing” në lëndën e gjuhës angleze.




Figura 9- Picture credit: Quizlet

- Quizlet mund të përdoret nga mësuesi edhe për të testuar njohuritë gramatikore të nxënësve nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme. Fig.10 tregon një shembull se si një mësues, për të parë se sa mirë nxënësit e tij e kanë kuptuar strukturën e fjalisë në kohën e tashme kur përdoren ndajfolje kohore të ndryshme, ka krijuar një paketë me kartela treguese ku nga një anë vendos fjalët e përziera dhe nga ana tjetër fjalinë e saktë.

My brother is always happy at work	happy / My / always / is / brother / at work.
He does not often listen to music.	music. / He / listen to / does / not / often
He never slows down.	slows down. / never / He




Figura 10- Picture credit: Quizlet

- Quizlet ofron gjithashtu një lojë që nxënësit mund ta luajnë me grupe në klasë, e cila quhet Quizlet Live. Kjo lojë mundëson nxënësit që të shkëmbejnë njohuritë e marra në mënyrë argëtuese. Mësuesi nxit nxënësit të bashkëpunojnë dhe të krijojnë paketën e tyre të kartelave treguese dhe, pastaj grupet zgjidhin ushtrimet e krijuara nga grupet e tjera. Në këtë mënyrë nxënësit forcojnë vetëbesimin, aftësinë e të menduarit kritik, vetëvlerësimin, autonominë dhe frymën e bashkëpunimit.



## GooseChase.com

GooseChase është një platformë online e cila ndihmon mësuesit të krijojnë lojën “Scavenger hunt” (në kërkim të thesarit). Për të zgjidhur këtë lojë kërkuese, nxënësit përdorin telefonat e tyre dhe organizohen në grupe në mënyrë që të zhvillojnë një kërkim bashkëpunues dhe konkurues në të njëjtën kohë. Pasi mësuesi krijon lojën, ai/ajo shton nga një të dhënë për lojën, e cila mund të jetë foto, video, tekst ose vendndodhje. Pyetjet që kanë foto dhe video janë më të pëlqyerat. Kjo lojë kërkon nga nxënësit të bëjnë foto të grupit të tyre me secilin nga objektet që u kërkohet të gjejnë dhe ta vendosin foton/video/tekstin ose vendndodhjen në GooseChase. Mësuesi monitoron veprimtarinë, zgjedh objekte në faqe të sigurta dhe vendos kohën e kërkimit. Mësuesi mund të përdorë edhe lojëra të përgatitura nga mësues të tjerë dhe është i lirë t'i modifikojë ato sipas dëshirës. Kur loja ka përfunduar, mësuesi mund të shkarkojë materialet dhe t'i përdorë ato me nxënësit.



## **Shembuj:**

- Mësuesi mund ta përdorë GooseChase në orët e përsëritjes së fjalorit të marrë në një kapitull. Nëse në një kapitull është folur për mbiemrat që përdoren për të përshkruar njerëzit ose sendet, mësuesi u cakton detyrë nxënësve që të takojnë mësues dhe pjesëtarë të stafit të shkollës si dhe të vizitojnë ambiente të ndryshme të shkollës për të zgjidhur detyrën e dhënë e cila mund të përfshijë:
  - *kombino përshkrimin e dhënë me fotot e marra*
  - *gjej personin i cili është përshkruar dhe bëj një foto me atë person*
  - *vizato një pikturë sipas përshkrimit të dhënë*
- Përdorimi i GooseChase ndihmon nxënësit në të kuptuarin e një teksti të dhënë. Pasi nxënësit kanë lexuar një tregim ose novelë, mësuesi mund të krijojë lojën në GooseChase dhe u kërkon nxënësve, që duke ju referuar përsëri tregimit ose novelës, të zgjidhin detyrën e dhënë. Disa lloje detyrash në këtë rast mund të jenë:
  - *Krijë një video duke ju referuar skenave të ndryshme nga tregimi*
  - *Shkruaj një mbyllje tjetër ose aktro tregimin e dhënë*
  - *Harto disa pyetje për një quiz*
  - *Krahaso personazhe të ndryshme ose pikëpamjet e tyre në tregim.*
- Mësuesi mund ta përdorë GooseChase në një orë mësimi kur do të vlerësojë nxënësit për rezultatin e të nxënësve "Nxënësi kupton dhe zbaton udhëzimet e dhëna." Mësuesi krijon një detyrë në GooseChase me udhëzime të ndryshme me shkrim ose të regjistruara. Nxënësve u kërkohet të ndjekin udhëzimet e dhëna dhe të shkojnë në ambiente të ndryshme të shkollës duke fotografuar, ose një detyrë të caktuar për të provuar që i kanë ndjekur udhëzimet në mënyrë korrekte. Gjithashtu mësuesi krijon një detyrë në GooseChase ku nxënësve u kërkohet të japin udhëzime për shokët e tyre.







## Bubbl.us

Bubbl.us është një mjet i cili përdoret kur nxënësit janë online dhe ndihmon për organizimin e ideve nëpërmjet hartës së koncepteve. Hapat për krijimin e llogarisë online janë të thjeshta dhe të shpejta. Si të gjitha hartat e tjera, edhe bubbl.us fillohet me një rreth ku shkruhet ideja kryesore (ose ideja e projektit, nëse nxënësit janë duke punuar për një projekt).

Hartat e krijuara mund të ruhen për t'u punuar më vonë ose të ndahen me nxënës të tjerë.



### Shembuj:

Fig.11 tregon punën që nxënësit po bëjnë në një orë të gjuhës angleze. Tema e mësimit është “Cyber bullying”. Nxënësit punojnë në grupe për të identifikuar shkaqet dhe pasojat e këtij fenomeni shoqëror. Pas identifikimit të shkaqeve dhe pasojave, nxënësit diskutojnë rreth zgjidhjeve të mundshme të këtij problemi. Në fund të orës së mësimit, nxënësit prezantojnë gjetjet e tyre.




Figura 11- Picture credit: Bubbl.us





Figura 12- Picture credit: Bubbl.us

Në një orë mësimi të gjuhës angleze, mësuesi ka planifikuar teknikën stuhi mendimesh për të filluar orën e mësimi me temë "Sports". Për këtë veprimtari, klasa është ndarë në grupe dhe nxënësit përdorin bubbl.us. Nxënësit, pasi diskutojnë dhe shkëmbejnë mendimet e tyre rreth sporteve të ndryshme, plotësojnë hartën e mendimit me sa më shumë informacione që ata kanë rreth sporteve të ndryshme duke i klasifikuar ata sipas kategorive që ka përcaktuar mësuesja. Fig. 12 tregon ndarjen e kategorive që ka përgatitur mësuesi i gjuhës angleze për nxënësit në klasifikimin e sporteve të ndryshme.



## Mentimeter.com

Mentimeter është një platformë digjitale e cila përdoret për të krijuar prezantime interaktive, duke rritur përfshirjen e nxënësve në faza të ndryshme të orës së mësimi (hyrjes, prezantimit ose vlerësimit). Mentimeter gjithashtu mund të përdoret për të testuar nxënësit mbi aftësitë e tyre gjuhësore, gramatikore ose fjalorin. Nxënësit marrin rezultatet e testit menjëherë.



The screenshot shows the Mentimeter website homepage. At the top left is the Mentimeter logo. To its right are navigation links: Features, Solutions, Resources, Pricing, and Enterprise. Further right are 'Log In' and 'Sign up' buttons. The main heading reads 'Engage your audience & eliminate awkward silences'. Below this is a sub-headline: 'Our easy-to-build presentations, interactive Polls, Quizzes, and Word Clouds mean more participation and less stress'. A prominent blue 'Sign up' button is centered, with the text 'No credit card needed' underneath it. At the bottom, there is a large graphic with the word 'Hello' in a stylized font, overlaid with a 'Watch video' button.

### Shembuj:

- Fig.13 tregon si Mentimeter është përdorur në orën e gramatikës së gjuhës angleze me temën “Prefixes and Suffixes”. Mësuesi, pasi ka shpjeguar përdorimin e parashtesave dhe prapashtesave, poston një pyetje në Mentimeter për të kontrolluar se si nxënësit kanë kuptuar konceptet e reja. Secili nxënës, pasi merr kodin e dhënë nga mësuesi, poston nga një shembull ose më shumë të fjalëve të formuara me to. Pasi të gjithë nxënësit kanë postuar, mësuesi bën një përmbledhje të shembujve të dhënë.



2 slides

Figura 13- Picture credit: Mentimeter

- Një mënyrë tjetër për ta bërë orën e mësimit interesante dhe tërheqëse për nxënësit, është përdorimi i Mentimeter për vlerësimin e orës së mësimit nga vetë nxënësit. Mësuesi u kërkon nxënësve në Mentimeter: “Shkruaj një gjë që ju pëlqeu nga mësimi i sotëm” dhe nxënësit postojnë mendimin e tyre. Pasi janë marrë të gjitha komentet, mësuesi kërkon nga nxënësit të japin argumente që mbështesin mendimin e tyre duke ndihmuar ata të përmirësojnë aftësitë e tyre folëse dhe argumentuese. Figura 14 tregon se si nxënësit kanë komentuar për orën e mësimit të zhvilluar.




Figura 14- Picture credit: Mentimeter

- Mentimeter mund të përdoret me nxënës të niveleve të ndryshme gjuhësore. Në nivelin mesatar ose të avancuar, mësuesi përdor Mentimetër për t'u kërkuar nxënësve të listojnë pyetje ose fjali të dhëna sipas rëndësisë së tyre. Kjo lloj përzgjedhjeje ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të menduarin kritik dhe të praktikojnë aftësitë e tyre debatuese. Nxënësit reflektojnë rreth temave abstrakte dhe krijojnë argumenta për të mbështetur zgjedhjet e tyre. Në një orë mësimi me temën "Protecting our environment" mësuesi u kërkon nxënësve të listojnë problemet (such as greenhouse gas emissions, water pollution, deforestation, etc.) sipas rëndësisë së tyre. Pas votimit, nxënësit diskutojnë dhe japin argumentet e tyre për zgjedhjet që kanë bërë.
- Fig.15 tregon rezultatet e një votimi që një mësues i gjuhës angleze ka zhvilluar në orën e parë të vitit shkollor duke përdorur Mentimeter. Për të vendosur tri rregullat bazë të orës së mësimi nga vetë nxënësit, atyre u kërkohet të votojnë për pesë rregulla, duke i listuar sipas rëndësisë (Be on time; Listen carefully; Raise your hand; Give your best effort; Respect others). Në klasat e nivelit të lartë, mësuesi u kërkon nxënësve të argumentojnë: "Përse mendoni që këto janë rregullat më të rëndësishme për t'u zbatuar?"




Figura 15- Picture credit: Mentimeter

# Bibliografia

- <https://www.techlearning.com/how-to/best-tools-for-teachers>
- <https://www.classcraft.com/blog/playing-games-in-the-classroom/>
- <https://fltmag.com/mentimeter/>
- <https://quizlet.com/blog/teacher-to-teacher-five-ways-to-use-quizlet-in-the-language-classroom>
- <https://www.mentimeter.com/>
- <https://www.ecml.at/>
- <https://www.goosechase.com/>
- <https://www.cultofpedagogy.com/start-here/>
- Turner, A. 2015. Generation Z: Technology and social interest. *The Journal of Individual Psychology*
- Feedspot. 2020. "Top 75 Educational Technology Blogs And Websites For Educators in 2020."  
[https://blog.feedspot.com/educational\\_technology\\_blogs/](https://blog.feedspot.com/educational_technology_blogs/)
- Flipgrid. 2020. "Getting Started." <https://blog.flipgrid.com/amplify>
- FutureLearn. 2020. "How to Teach Online Courses."  
<https://www.futurelearn.com/subjects/teaching-courses/how-to-teachonline>
- Heift, T., A. Mackey, and B. Smith. 2019. History, pedagogy, data and new directions: An introduction to the educational technology issue. *Annual Review of Applied Linguistics*
- Lord, G., and L. Lomicka. 2008. Blended learning in teacher education: An investigation of classroom community across media. *Contemporary Issues in Technology and Teacher Education*
- <https://www.studentum.fr/articles-and-advice/5-reasons-online-learning-is-future-of-education-17146>
- <https://iciftech.ensam.eu/transformer-son-enseignement>
- <https://www.aston-ecole.com/2021/03/24/l-enseignement-hybride-kezaco/>
- <https://www.ispring.fr/blog/blended-learning>
- <https://www.profweb.ca/publications/articles/differents-modeles-d-enseignement-en-presentiel-a-distance-comodal-et-hybride>

